



Financuar nga
Bashkimi Evropian



SHËRBIME SOCIALE AFËR QYTETARIT

RAPORT MONITORIMI MBI PROCESIN
E DECENTRALIZIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE



SHËRBIME SOCIALE AFËR QYTETARIT

RAPORT MONITORIMI MBI PROCESIN
E DECENTRALIZIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE

PËRMBAJTJA

HYRJE	8
QËLLIMI	9
METODOLOGJIA	9
MBULIMI GJEOGRAFIK.....	10
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	11
FUNKSIONALIZIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE GJATË PANDEMISË	14
Rritje e kërkesës për shërbime sociale dhe rritje e theksuar e rasteve të dhunës në familje	16
ZVARRITJE E PROCESEVE LEGJISLATIVE QË RREGULLOJNË SHËRBIMET SOCIALE.....	18
Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare	20
Ligji për Financat e Pushtetit Lokal.....	21
Formula e financimit për shërbime sociale.....	22
FINANCIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE.....	23
Financimi i shërbimeve sociale nga niveli qendror gjatë vitit 2021	24
Financimi i shërbimeve sociale nga niveli komunal gjatë vitit 2021	27
Financimi për Qendrat për Punë Sociale:	27
Financimi për sektorin joqeveritar:.....	30
KAPACITETET E KOMUNAVE PËR SHËRBIME SOCIALE	38
Kapacitetet e Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në menaxhimin e shërbimeve sociale	39
Kapacitetet e Qendrave për Punë Sociale në ofrimin e shërbimeve sociale.....	42
RAPORTIMI	44
INSPEKTIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE	47
MONITORIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE.....	50
LICENCIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE	51
PËRFUNDIMI	52
REKOMANDIMET	54
SHTOJCAT	58

Ky publikim mundësohet në kuadër të projektit “Aksioni i Përbashkët për Decentralizim”, projekt i financuar nga Bashkimi European dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, i cili implementohet nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF në partneritet me Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e konsorciumit të udhëhequr nga KOMF dhe nuk pasqyron me doemos pikëpamjet e Bashkimit European.

Autorë:

Bukurezë Surdulli, Specialiste për Monitorim dhe Hulumtim në KOMF
Donjetë Kelmendi, Drejtor Ekzekutiv në KOMF

FALENDERIME

Në emër të misionit të përbashkët për mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF falenderon të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij raporti, i cili ka qëllimin të nxisë dhe ndihmojë përmbylljen e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale.

KOMF shpreh një falenderim të veçantë për të gjithë ata që u angazhuan dhe u përfshinë në realizimin e këtij monitorimi:

- Qendrat për Punë Sociale në Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Kamenicë;
- Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Kamenicë;
- Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamentin për Politika Sociale dhe Familjes si dhe Departamentin për Buxhet;
- Organizatat Jo Qeveritare.

SHKURTESAT

AKTI	Organizata Rinore – Akti
COVID-19	Coronavirus Disease
DMS	Drejtoria Komunale e Mirëqenies Sociale
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare
DSK	Down Syndrome Kosova
DSHMS	Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
IKSHKP	Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike në Kosovë
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
LSHSF	Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
NOPM	Rrjeti i Lëvizjes Paqësore
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MeF	Ministria e Financave
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
QPS	Qendra për Punë Sociale
UA	Udhëzim Administrativ

HYRJE

Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste e veçanta, ndihmës materiale për njerëzit në nevojë sociale. Përderisa ofrues të shërbimeve sociale janë institucionet publike dhe organizatat jo qeveritare.

Decentralizimi i shërbimeve sociale ka filluar në vitin 2009, ku janë bartur kompetencat nga niveli qendror drejt komunave të Kosovës.¹ Qëllimi i decentralizimit të shërbimeve sociale ka qenë që këto shërbime të jenë sa më afër qytetarit. Megjithatë, ky proces nuk është përmbyllur akoma.

Shërbimet sociale në Kosovë rregullohen me Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Sipas LSHSF, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është institucioni përgjegjës për të gjitha politikat, licencimin, monitorimin, inspektimin dhe çështjet rregullative në lidhje me punën dhe mirëqenien sociale. Përveç kësaj, MFPT rregullon edhe sektorin jo qeveritar të ofrimit të shërbimeve sociale, duke qenë përgjegjëse për licencimin e organizatave jo qeveritare për shërbime sociale. Ndërkaq sipas LVQL, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Komunat kanë mandatin për të marrë përgjegjësinë mbi çështjet e mirëqenies sociale të tyre dhe bëjnë menaxhimin e Qendrave për Punë Sociale. QPS-të janë institucione publike të formuara në nivel komunal, për ofrimin e shërbimeve përkatëse. Sa i përket financimit të shërbimeve sociale, sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, ato financohen nga Granti i Përgjithshëm dhe të hyrat vetanake komunale.

Ky raport monitorimi paraqet të gjeturat lidhur me gjendjen e shërbimeve sociale dhe ofron rekomandimet për institucionet relevante me qëllim të përmirësimit të mirëqenies sociale.

¹ Memorandum i Mirëkuptimit mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Financave dhe komunave, 2009

QËLLIMI

Raporti mbi monitorimin e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale për vitin 2021, ka si qëllim kryesor pasqyrimin e gjendjes aktuale mbi zbatimin e plotë të këtij procesi. Raporti paraqet të dhëna mbi gjendjen e ofrimit të shërbimeve sociale për qytetarët në nevojë, proceset legjislative, financimin e shërbimeve sociale, raportimin për shërbime sociale, monitorimin dhe inspektimin e shërbimeve sociale, sfidat dhe nevojat e ofruesve të shërbimeve sociale për vitin 2021.

Më tej, Raporti i Monitorimit ofron të gjetura konkrete dhe rekomandime për përmirësimin e gjendjes aty ku vërehen mangësi. Të gjitha rekomandimet janë të mbështetura në dokumente, hulumtime, praktika ndërkombëtare dhe vendore, si dhe rekomandime të akterëve përgjegjës për zbatimin e procesit të decentralizimit.

Gjithashtu, përmes këtij raporti synohet të bëhet krahasimi i progresit të procesit të decentralizimit me vitin 2019 dhe vitit 2020.

METODOLOGJIA

Metodologjia e hartimit të raportit mbështetet në mbledhjen e të dhënave të bazuara në metodën cilësore që përfshin analizën teorike dhe hulumtimin në terren. Specifikisht, ky raport monitorimi bazohet në:

- Analizën e legjislacionit;
- Analizën e publikimeve relevante;
- Intervistat me përfaqësuesit relevantë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

Konkretisht, gjithsej janë realizuar 23 intervista në shtatë komuna të Kosovës. Intervistat janë realizuar me përfaqësues të nivelit qendror dhe komunal:

- Tre (3) intervistave përfaqësues të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve;
- Gjashtë (6) intervistave me përfaqësues të Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Gjashtë (6) komuna të Kosovës;
- Shtatë (7) intervistave me përfaqësues të Qendrave për Punë Sociale në shtatë (7) komuna të Kosovës;
- Tetë (8) intervistave me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Pandemia Covid-19 ka ndikuar në mënyrën e organizimit të intervistave. Për shkak të masave për parandalimin e Covid-19, KOMF ka realizuar pjesën më të madhe të intervistave përmes platformave virtuale. KOMF ka mbajtur dy (2) intervistave fizikisht dhe njëzet e një (21) intervistave në formë virtuale. Sfida kryesore në realizimin e intervistave ka qenë ndryshimi i drejtorëve të Drejtorive Komunale për Mirëqenie Sociale si rezultat i zgjedhjeve komunale, ku drejtorët e komunave të monitoruara janë emëruar deri në fillim të vitit 2022. Kjo solli vështirësi në kontaktimin, intervistimin dhe marrjen e informacioneve nga drejtorët e rinj për decentralizimin e shërbimeve sociale për vitin 2021. Megjithatë, drejtorëve ju është rekomanduar që të mbajnë intervistat/takimet së bashku me zyrtarët për shërbime sociale të cilët kanë qenë pjesë e proceseve përgjatë vitit 2021. Nga shtatë (7) drejtorët për mirëqenie sociale, me një (1) prej tyre nuk është realizuar intervista për shkak të mungesës së përgjigjes ndaj kërkesës për intervistë.²

MBULIMI GJEORAFIK

Monitorimi është realizuar me përfaqësues që vijnë nga shtatë komuna të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Kamenicë.

Përzgjedhja e komunave është bërë për të:

- Siguruar mbulimin gjeografik të Kosovës;
- Përfshirë komunat me numër më të madh të banorëve dhe rrjedhimisht me numër më të madh të rasteve sociale sikurse Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Ferizajt;
- Përfshirë komunat e vogla por me numër më të madh të problemeve sociale sikurse Komuna e Fushë Kosovës;
- Përfshirë komunat me numër më të madh të komuniteteve etnike pakicë në Kosovë, sikurse Komuna e Lipjanit dhe ajo e Kamenicës.

² Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale në Komunën e Pejës nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën për intervistë



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në krahasim me vitin 2020, ku shërbimet sociale ishin të kufizuara për shkak të masave për parandalimin e Covid-19, në vitin 2021 shërbimet sociale u funksionalizuan dhe ishin të qasshme për qytetarët në nevojë. Në vitin 2021 është parë një adaptim i ofruesve të shërbimeve me situatën pandemike. Duhet theksuar që nevoja për shërbime sociale ka qenë në rritje edhe përgjatë vitit 2021, ndërsa kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale nuk janë shtuar.

Proceset e nisura legjislative që rregullojnë shërbimet sociale dhe financimin e tyre, kanë vazhduar të zvarriten dhe nuk kanë arritur të përmbyllen. Përkundër parashikimeve të planit legjislativ të Qeverisë për vitin 2021, dy projektligjet kryesore që pritet të ndikojnë në decentralizimin dhe avancimin e shërbimeve sociale, që janë Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, nuk arritën të procedohen për miratim. Krahas mungesës së vullnetit politik për të shtyrë përpara miratimin e këtyre dy projekt ligjeve, ndikim të madh patën edhe pandemia dhe proceset zgjedhore që ndodhën në vitin 2021.

Financimi i shërbimeve sociale mbetet sfida kryesore në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2021. As në vitin 2021, nuk ka pasur ndonjë progres sa i përket decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale, për shkak të mos aprovimit të projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Përkundër rekomandimeve të vazhdueshme të shoqërisë civile, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe komunat, nuk krijuan një skemë të qëndrueshme të blerjes së shërbimeve sociale. Mbështetja për sektorin jo qeveritar ka vazhduar të bëhet përmes subvencionimit për periudha të shkurtra, e cila nuk konsiderohet si formë e qëndrueshme e financimit. Vlen për tu përmendur fakti se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka rritur shumën e financimit të shërbimeve të sektorit joqeveritar në krahasim me vitin 2020. Po ashtu, nga shtatë komunat e monitoruara, progres ka pasur Komuna e Prishtinës e cila ka shënuar rritje të financimit për sektorin jo qeveritar në tri vitet e fundit.

Gjatë vitit 2021, kapacitetet e komunave për menaxhim dhe ofrim të shërbimeve sociale kanë vazhduar të jenë të mangëta sikur në dy vitet paraprake. Mungesa e stafit profesional në shërbime sociale brenda DSHMS është raportuar si vështirësi kyçe në menaxhimin e shërbimeve. Në të gjitha komunat DSHMS-të dhe QPS-të kanë nevojë për rritje të numrit të stafit, sidomos rritje të numrit të zyrtarëve të shërbimeve sociale dhe ngritje të kapaciteteve

të zyrtarëve për financa. Mesatarja e trajtimit të rasteve nga një zyrtar për shërbime sociale në Qendrën për Punë Sociale në Prizren është 170 raste. Komunat dhe QPS-të nuk janë të përgatitura për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për shërbime sociale. Mungojnë aktivitete të ngritjes së kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim të buxhetit, mungon vlerësimi i nevojave në secilën komunë dhe bashkëpunimi i mirëfilltë në mes të QPS-ve dhe DSHMS-ve për hartim të një planifikimi buxhetor të përbashkët konform këtyre nevojave. Planifikimi buxhetor i komunave është i prirur të përsërisë planifikimet buxhetore paraprake, pa ndonjë vlerësim real e të përditësuar mbi nevojat e qytetarëve për shërbime sociale.

Mandati i monitorimit dhe inspektimit i shërbimeve sociale ka vazhduar të jetë i pa qartë dhe i pa definuar. Njësia për Monitorim dhe Inspektim në kuadër të MFPT ka mungesë të kapaciteteve njerëzore për të realizuar procese të inspektimit. Po ashtu kjo Njësi ende nuk ka kompetenca ekzekutive, gjë që e zbeh rolin e inspektimit tek ofruesit e shërbimeve sociale.

Në vitin 2021, asnjë nga ofruesit e shërbimeve nuk ka pasur monitorim të mirëfilltë nga komunat - DSHMS-të apo monitorim të jashtëm. Komunat nuk i kanë instrumentet dhe kapacitetet e nevojshme për të zhvilluar proces të monitorimit për ofruesit e shërbimeve sociale.



FUNKSIONALIZIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE GJATË PANDEMISË

FUNKSIONALIZIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE GJATË PANDEMISË

Bazuar në të dhënat e monitorimit, në krahasim me vitin 2020, viti 2021 ishte më i lehtë sa i përket adaptimit në ofrimin e shërbimeve sociale në pandemi. Megjithatë, pandemia ka rënduar ndjeshëm situatën e grupeve të cënueshme dhe kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve në nevojë për shërbime sociale.

Ofrimi i shërbimeve sociale nga Qendrat për Punë Sociale dhe organizatat jo qeveritare është bërë në përputhje të plotë me vendimet dhe masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin e Covid-19.

Pandemia padyshim ka ndikuar në mbrojtjen sociale, shëndetësore dhe arsimore të fëmijëve, ndonëse nuk dihet saktë niveli i tërthortë i ndikimit, i cili sipas shumë ekspertëve të fushës, do të jetë me shumë pasoja dhe i pranishëm për një kohë të gjatë në jetën e fëmijëve.³

Sipas organizatave jo qeveritare që ishin pjesë e monitorimit, ndërprerja dhe pezullimi i shërbimeve sociale për fëmijët ka ndikuar negativisht në progresin e tyre. Ky stagnim është vënë re sidomos tek fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët kanë qenë përfitues të shërbimeve sociale në kuadër të qendrave ditore. Megjithëse shërbimet ishin përshtatur për tu ofruar përmes formave virtuale të cilat synonin edhe fuqizimin e shkathtësive të prindërve për zhvillimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të caktuara në kushte shtëpie, ndikimi i tyre ishte më i zbehtë në rritjen e progresit të fëmijëve.

Kjo është evidentuar edhe nga Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, ku theksohet se ndërprerja dhe pezullimi i disa shërbimeve ka përkeqësuar gjendjen shëndetësore të fëmijëve duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Pra, ndërprerja dhe pezullimi i terapi fizio-rehabilituese, terapi këshilluese psiko-sociale dhe programeve të mbështetjes ditore, i kanë privuar fëmijët me aftësi të kufizuara nga shërbimet bazike terapeutike rehabilituese. Sipas të njëjtit raport, në raste të caktuara kjo ka mundur ta rrezikonte edhe vetë jetën dhe zhvillimin e fëmijëve. Për më tepër, barra e sigurimit të këtyre shërbimeve ka rënë mbi prindërit ose mbi kujdestarët e tyre. Kjo barrë përveç aspektit financiar, është vështirësuar në masë të madhe edhe në gjetjen e alternativave në mënyrë që fëmijëve të mos u ndërpriteshin shërbimet e planifikuara.⁴

³ Raport i veçantë "Emergjencë shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës", Avokati i Popullit, <https://oik-rks.org/2021/12/10/raport-i-vecante-emergjenc-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-e-njeriut-ne-republiken-e-kosoves/>

⁴ Raporti Vjetor 2021, Avokati i Popullit, <https://oik-rks.org/2022/03/31/raporti-vjetor-2021/>

Përkundër kufizimit të masave në periudha të caktuara, përgjatë vitit 2021 ofruesit e shërbimeve sociale kanë vazhduar punën dhe kanë ofruar shërbime për personat në nevojë pa ndonjë pengesë.

Ofruesit e shërbimeve kanë deklaruar që as në vitin 2021 nuk u është ofruar ndonjë manual ose udhëzues i veçantë mbi ofrimin e shërbimeve sociale në pandemi, nga Ministria e Shëndetësisë ose ndonjë organ tjetër kompetent. Udhëzuesit e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, nuk kanë në përmbajtje rekomandime apo udhëzime specifike për ofrim të shërbimeve sociale direkte në pandemi në qendrat e kujdesit ditor, strehimoret dhe shtëpitë me bazë në komunitet. Sipas Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Kamenicë, Rifat Hajdari, ka pasur raste kur është dashur të bëjnë vizita në shtëpi dhe të shmangin kontaktin me familje, dhe në këto raste nuk kanë pasur ndonjë udhëzues të veçantë se si të sillen por punëtorët social janë munduar të veprojnë sipas rekomandimeve të përgjithshme të Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike në Kosovë.⁵ Përkundër kësaj, sipas Liridona Zogaj, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën Ditore “Pema”, akterët komunal kanë qenë më të bashkuar në ofrimin e mbështetjes përgjatë vitit 2021 në krahasim me vitin 2020 dhe organizata ka qenë më e përgatitur në ofrimin e shërbimeve.⁶ Ka pasur raste kur organizatat kanë përshtatur udhëzues të ngjashëm për ofrim të shërbimeve sociale. Organizata Down Syndrome Kosova, ka përdorur dhe përshtatur manualin për rikthim në shkollë të MASHTI për ofrim të shërbimeve sociale⁷.

Për tu ardhur në ndihmë ofruesve të shërbimeve sociale, KOMF ka publikuar Udhëzuesin për parandalimin e Covid-19 në Shërbime Sociale në muajin Dhjetor 2021.⁸

Rritje e kërkesës për shërbime sociale dhe rritje e theksuar e rasteve të dhunës në familje

Si në vitin 2020, ashtu edhe në vitin 2021, ofruesit e shërbimeve sociale janë përballur me rritje të numrit të rasteve në nevojë për shërbime sociale, veçanërisht rritje të numrit të rasteve me dhunë në familje.

Në Komunën e Fushë Kosovës në vitin 2021 QPS ka trajtuar 140 raste të dhunës në familje, me një rritje prej mbi 50% në krahasim me vitet paraprake, ku numri i rasteve të dhunës në këtë komunë ka qenë 40-50 raste në vit. Problematikë tjetër në këtë komunë, ka qenë edhe rritja e numrit të rasteve të fëmijëve në situatë rruge për shkak të ndërprerjeve të shumta të procesit mësimor. Forma e vetme e mbështetjes që QPS ka arritur të sigurojë, ka qenë dërgimi

⁵ Intervistë me Rifat Hajdari, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Kamenicës, 10 Shkurt 2022

⁶ Intervistë me Liridona Zogaj, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën Ditore “Pema”, 9 Shkurt 2022

⁷ Intervistë me Ermira Shabani, Udhëheqëse Nacionale e Programit të Shërbimeve në Down Syndrome Kosova, 3 Shkurt 2022

⁸ Udhëzues për parandalimin e Covid-19 në Shërbime Sociale, KOMF, 2021, <https://komfkosova.org/udhezues-per-parandalimin-e-covid-19-ne-sherbime-sociale/>

i fëmijëve në qendrën ditore për fëmijët në situatë rruge të organizatës Terre des hommes, e cila ndodhet në Prishtinë.⁹ Edhe në Komunën e Ferizajt, numri i rasteve për shërbime sociale është rritur në dy vitet e fundit. Në vitin 2021, janë trajtuar 27 raste të dhunës në familje, që shënon numrin më të madh të rasteve në 10 vitet e fundit, në këtë komunë.¹⁰ Edhe në Komunën e Kamenicës vërehet një rritje substanciale e rasteve të dhunës në familje në vitin 2021. QPS ka trajtuar 30 raste për dhunë në familje në vitin 2021, ndërsa në vitin 2020 kanë qenë 12 raste të dhunës në familje. Gjithashtu, diskrepancë është vënë re edhe në raste të natyrave të tjera si trajtimi i rasteve të fëmijëve me sjellje asociale ku në vitin 2021 kanë qenë 22 raste ndërsa në vitin 2020 ishin 3 raste, fëmijëve në konflikt me ligjin ku në vitin 2021 kanë qenë 24 raste ndërsa në vitin 2020 ishin trajtuar 9 raste, apo fëmijëve të keqtrajtuar ku në vitin 2021 janë trajtuar 10 raste ndërsa në vitin 2020 asnjë rast.¹¹ Në komunën e Prizrenit, QPS në vitin 2021 ka trajtuar 120 raste të dhunës në familje, përderisa në vitin 2020 ishin trajtuar gjithsej 70 raste.¹² Në raport me vitin 2020 edhe në Komunën e Prishtinës vërehet rritje e rasteve të dhunës në familje. Në vitin 2020, QPS në Prishtinë ka trajtuar 178 raste të dhunës në familje, ndërsa në vitin 2021 ka trajtuar 219 raste të dhunës në familje.¹³

Edhe ofruesit e shërbimeve nga sektori joqeveritar kanë pohuar se kanë pasur rritje të kërkesave për ofrim të shërbimeve sociale. Përkundër ambientimit në punë gjatë pandemisë, të gjithë kanë deklaruar se kanë pasur sfida të ndryshme gjatë ofrimit të shërbimeve. Në organizatën Down Syndrome Kosova, numri i rasteve të shtuara gjatë pandemisë në krahasim me numrin e përfituesve statik, ka qenë 35 raste të fëmijëve (9 Prishtinë, 21 Prizren dhe 5 Ferizaj).¹⁴ Ndërsa edhe në Qendrën e Kujdesit Ditor “Pema” është vënë re rritje e numrit të rasteve, sidomos rritje të referimeve të rasteve që vijnë direkt nga familjet. Sipas Drejtoreshës së kësaj qendre, Liridona Zogaj, në fillim kur janë krijuar qendrat ditore referimet më të mëdha kanë ardhur nga QPS-të, ndërsa viteve të fundit referimet vijnë kryesisht nga familjet.¹⁵ Kjo tregon edhe rritje të vetëdijes së familjeve për rëndësinë e marrjes së shërbimeve për fëmijët në nevojë për shërbime sociale.

Në Qendrën për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, sfida ka qenë ofrimi i shërbimeve jashtë qendrës dhe shërbimet për reintegrim. Sipas Teuta Abrashit, Drejtoreshë në MVPT, procesi i reintegrimit ka stagnuar gjatë vitit 2021 për shkak të masave për parandalimin e pandemisë, ku shpesh herë ka pasur ndërprerje të punës.¹⁶

⁹ Intervistë me Abaz Gjigoli, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Fushë Kosovës, 2 Shkurt 2022

¹⁰ Intervistë me Adelina Rexhepi, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Ferizajt, 16 Shkurt 2022

¹¹ Intervistë me Rifat Hajdari, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Kamenicës, 10 Shkurt 2022

¹² Të dhëna nga Kumrije Bytyqi, Qendra për Punë Sociale në Komunën e Prizrenit, 13 Prill 2022

¹³ Intervistë me Blerim Shabani, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Prishtinës, 11 Shkurt 2022

¹⁴ Intervistë me Ermira Shabani, Udhëheqëse Nacionale e Programit të Shërbimeve në Down Syndrome Kosova, 3 Shkurt 2022

¹⁵ Intervistë me Liridona Zogaj, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën e Kujdesit Ditor “Pema”, 9 Shkurt 2022

¹⁶ Intervistë me Teuta Abrashi, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 1 Shkurt 2022



ZVARRITJE E PROCESEVE LEGJISLATIVE QË RREGULLOJNË SHËRBIMET SOCIALE

ZVARRITJE E PROCESEVE LEGJISLATIVE QË RREGULLOJNË SHËRBIMET SOCIALE

Në bazë të analizës së kornizës ligjore, mangësi të shumta të cilat pengojnë kompletimin e procesit të decentralizimit por edhe përmirësimin e gjendjes së shërbimeve sociale, janë identifikuar në Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare,¹⁷ Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare¹⁸ dhe Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.¹⁹

Të dy projekt ligjet, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, kanë filluar të hartohen në vitin 2018. Edhe pse janë të finalizuara prej kohësh tashmë, për shkak të mungesës së vullnetit politik, pandemisë Covid-19 dhe situatës së paqëndrueshme politike në vend, këto dy projektligje nuk arritën të miratohen as gjatë vitit 2021. Kjo është evidentuar edhe në Raportin e Progresit të BE për vitin 2021, ku thuhet se nuk ka pasur asnjë progres në reformat legjislative për të riorganizuar fondet dhe kompetencat ndërmjet qeverisjes qendrore dhe komunale, për të përcaktuar financimin e komunave bazuar në kriteret të qarta, të drejta dhe transparente si dhe për të krijuar një Grant Specifik për Shërbime Sociale.²⁰

Më 14 Shkurt 2021, u mbajtën Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku pas formimit të qeverisë së re ndodhën ndryshime esenciale në organizimin e ministrive. Me këtë rast, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Familjare e cila ishte përgjegjëse për mirëqenien sociale dhe skemat sociale, u shkri me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Kështu, shërbimet sociale dhe transferet sociale kaluan në MFPT. Kjo solli vonesa në vazhdimin e punës për shkak se për një kohë nuk u bë e ditur se si do të organizoheshin ministrinë.

Megjithatë, sipas Drejtorit të Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes në kuadër të MFPT, në vitin 2021 ka pasur fokus më të madh në programe sociale në krahasim me vitin 2020. Po ashtu, përkundër faktit që ligjet e parashikuara nuk janë aprovuar, MFPT ka arritur të finalizojë një numër të akteve nënligjore në pjesën e programit legjislativ.²¹ Makfirete

¹⁷ Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

¹⁸ Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

¹⁹ Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2525>

²⁰ Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2021, <file:///C:/Users/Lenovo/Downloads/Kosovo%202021%20report.PDF>

²¹ Intervistë me Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 28 Shkurt 2022

Shamolli, Drejtoreshë e QPS në Komunën e Lipjanit, ka thënë se planet qeveritare në vitin 2021 nuk kanë qenë proces i penguar nga pandemia. Sipas saj, zgjedhjet, konstituimi i Kuvendit, ministrive, komisioneve, shtyrja e planeve për reformë legjislative etj., kanë sjellë më tepër vonesa se sa faktori i pandemisë.²² Edhe Bashkim Rakaj nga QPS në Prizren mendon se nismat legjislative nuk janë bllokuar nga pandemia, duke qenë se janë realizuar aktivitete dhe punëtori normalisht.²³ Drejtori i DSHMS në Lipjan, Shkëlzen Hajdini mendon se pandemia nuk ka ndikuar në proceset e nisura më herët dhe nuk duhet të përdoret si arsye për mos-shtyrjen e proceseve përpara.²⁴

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare

Bazuar në të gjeturat e raportit të monitorimit të KOMF, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të nivelit qendror dhe komunal në Kosovë, nuk janë të përcaktuara në mënyrë të qartë. Institucionet e të dyja niveleve vazhdojnë të kenë paqartësi në përgjegjësitë e tyre lidhur me shërbimet sociale. Konkretisht paqartësitë më të mëdha rreth decentralizimit lidhen me themelimin e institucioneve të reja të shërbimeve sociale, menaxhimin, kontraktimin, raportimin, monitorimin dhe komunikimin. Për këtë arsye është rekomanduar që këto mangësi të adresohen në kuadër të Projekt Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Plani i Punës i Qeverisë dhe Plani Legjislativ për vitin 2021, ka parashikuar hartimin dhe miratimin e Ligjit të ri për Shërbimet Sociale dhe Familjare nga Qeveria deri në Dhjetor 2021, me qëllimin e zhvillimit të një reforme të thellë të shërbimeve sociale. Edhe pse ky Projekt Ligj u finalizua dhe u validua nga grupi punues në Tetor të vitit 2021, nuk arriti të miratohej as këtë vit. Gjithashtu, edhe gjatë vitit 2020, ky Projekt Ligj ka qenë e paraparë që të miratohet deri në Nëntor 2020 mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur, për shkak se Grupi Punues ka vlerësuar që draft Ligji ende ka nevojë për ndërhyrje.²⁵

Gjatë vitit 2021, KOMF ka vazhduar mbështetjen e hartimit të Draft Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare. KOMF në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ka mbajtur katër punëtori me grupin punues ku janë trajtuar komentet dhe rekomandimet specifike të ofruara nga KOMF bazuar në Qëndrimin e KOMF për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare. Si rezultat, propozimet e KOMF për klasifikimin e shërbimeve në tri kategori: primare, sekondare dhe terciare janë aprovuar. Poashtu janë aprovuar propozimet për

²² Intervistë me Makfirete Shamolli, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Lipjanit, 10 Shkurt 2022

²³ Intervistë me Bashkim Rakaj, Punëtor Social, Qendra për Punë Sociale në Komunën e Prizrenit, 10 Shkurt 2022

²⁴ Intervistë me Shkëlzen Hajdini, Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Lipjanit, 22 Mars 2022

²⁵ Shërbimet Sociale në Kohë Pandemie, KOMF, Prill 2021, https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-i-Monitorimit-2021-Shqip_compressed.pdf

integrimin e shërbimeve sociale me sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, zhvillimin e një skeme të hapur të ofrimit të shërbimeve sociale në mes të ofruesve publik, jo qeveritar dhe privat, fuqizimin e inspektimit përmes dhënies së kompetencave ekzekutive, licencimin e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike etj.

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal

Shërbimet sociale janë kompetencë vetanake komunale dhe bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal financohen nga komunat përmes dy burimeve të financimit që janë, granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake komunale. Granti i përgjithshëm është grant i tipit të mbyllur me 10% të të hyrave të projektuara që do të duhet të mblidhen në nivel qendror gjatë një viti kalendarik. Mirëpo problemi për shërbime sociale fillon pikërisht këtu, sepse kjo formë nuk ofron garanton që do të ketë ndarje të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet minimumi i financimit për shërbimet sociale. Kjo sepse nuk ka një formulë financimi të ndarjes së shumës për shërbimet sociale, duke ditur se nga këto shuma buxhetojnë të gjitha departamentet për shpenzimet operative dhe kapitale. Në mënyrë që ky funksion komunal të mos mbetet në vullnet të nivelit komunal, është sugjeruar krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale.

Gjatë vitit 2019 është hartuar Projekt Ligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal ku për herë të parë, pas shumë përpjekjesh dhe avokimit të vazhdueshëm, është paraparë dhe përfshirë në Projekt Ligj krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Projekt Ligji ka kaluar fazën e konsultimeve publike, megjithatë nuk është miratuar as në vitin 2021. Sekretari i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ka formuar grupin e ri të punës për LFPL, mirëpo nuk ka pasur ndonjë takim apo veprim të grupit pasi që nuk ka asnjë përgjigje nga kabineti i Ministrit.²⁶ Ky Projektligj ka mbetur pezull prej gati tri vitesh tashmë, dhe asnjë hap nuk është ndërmarrë në drejtim të miratimit të tij.

KOMF më 1 Qershor 2021 është takuar me Kryeministrin Albin Kurti ku ka adresuar kërkesën për zgjidhjen e financimit të shërbimeve sociale, duke kërkuar procedimin me urgjencë të Projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal me qëllim krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Me implementimin e këtij Granti, pritet të sigurohet një minimum i qëndrueshëm i financimit të shërbimeve sociale.

²⁶ Intervistë me Jeton Gashi, Udhëheqës i Divizionit për Buxhet Komunal, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 24 Mars 2022

Formula e financimit për shërbime sociale

Gjatë vitit 2019, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me vendim të veçantë krijoi një grup punues për hartimin e formulës së financimit për shërbime sociale, formulë kjo mbi të cilën do të bazohej shuma e buxhetit të ndarë në kuadër të Grantit Specifik për Shërbime Sociale. As gjatë vitit 2021, nuk ka arritur të finalizohet formula e financimit për shërbime sociale. Drejtori i Departamentit të Politikave Sociale dhe të Familjes në kuadër të MFPT, ka thënë se në vitin 2022 do të punohet në një analizë bazuar në Ligjin e ri për Financat e Pushtetit Lokal e cila do të reflektojë nevojat në vitin e parë të financimit të shërbimeve sociale. Sipas tij, me aprovimin e Projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, do të punohej në hartimin e një udhëzimi administrativ që rregullon funksionimin dhe shpërndarjen e Grantit Specifik për Shërbime Sociale.²⁷

²⁷ Intervistë me Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 28 Shkurt 2022



FINANCIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE

FINANCIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Financimi i shërbimeve sociale nga niveli qendror gjatë vitit 2021

Në vitin 2021, buxheti total i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (programet e ish-MPMS) ka qenë 512 milionë Euro. Krahasuar me buxhetin e Ministrisë të vitit 2020, buxheti i MFPT (pjesa ish MPMS) ka pësuar rënie prej 19 milionë Euro.

Sikurse në vitet paraprake, pjesa dërrmuese e buxhetit total është ndarë për skema dhe transfere, përkatësisht 489 milionë Euro, apo 96% e buxhetit të kësaj Ministrie. Skemat mbulojnë pensionet bazike-sociale dhe kontribut-dhënëse, pensionet e veteranëve, invalidëve të luftës, pensionet e aftësisë së kufizuar, kompensimin për të burgosurit politik, pensionet e parakohshme (Trepça) etj. Në kuadër të skemave, MFPT ka ndarë 3 milionë Euro për skemën për Përkrahje Materiale Familjeve që kanë Fëmijë me Aftësi të Përhershme të Kufizuara dhe 784,785 Euro për Programin e Strehimit familjar brenda familjes biologjike dhe jashtë familjes biologjike. Përderisa, 53 milionë Euro të transfereve janë të dedikuara për Skemën e Asistencës Sociale për familjet në varfëri, ku përfitues janë edhe fëmijët.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, vërtetohet se MFPT sikurse në vitin 2020 edhe gjatë vitit 2021, përkrahjen sociale e ka orientuar drejt ndihmës monetare mujore në kuadër të skemave sociale.

Buxheti i ndarë për shërbime sociale ka vazhduar të jetë shumë i ulët. Konkretisht, nga totali i buxhetit të MFPT prej 512 milionë Euro, MFPT në kuadër të shërbimeve sociale ka ndarë 2 milion Euro për Shtëpinë për Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë, 1 milion Euro për Institutin Special në Shtime dhe Shtëpinë e bazuar në komunitet në Shtime për fëmijët me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore.²⁸

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve gjatë 2021 ka vazhduar financimin e ofruesve të shërbimeve sociale nga sektori jo qeveritar përmes subvencionimit. MFPT ka bërë shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara nga MFPT në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare në Shkurt të vitit 2021. Shuma totale e planifikuar e thirrjes ishte 900,000 Euro. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohej për një projekt ishte 10,000 Euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt ishte 50,000

²⁸ Të dhëna nga Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 12 Prill 2022

Euro. Periudha e zbatimit të projektit në këtë thirrje ishte prej 6 deri në 10 muaj.²⁹ Më 14 Prill 2021, MFPT publikoi vendimin për OJQ-të e aprovuara dhe të refuzuara nga thirrja publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Bazuar në këtë vendim, 39 organizata ishin aprovuar për mbështetje financiare në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.³⁰



Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka rritur shumën e financimit në krahasim me vitin 2020. Në vitin 2020, MPMS kishte ndarë 355,000 Euro në fushën e shërbimeve sociale, ndërkaq në vitin 2021, ka ndarë 900,000 Euro, me një rritje prej 153%.

Vlen të përmendet që MFPT e ka rritur pragun e financimit për shërbimet sociale të sektorit jo qeveritar. Konkretisht, në vitin 2020 shuma maksimale për një projekt ishte 15,000 Euro për gjashtë muaj, në vitin 2019 shuma maksimale për një projekt ishte 40,000 Euro për 10 muaj, ndërkaq në vitin 2021 shuma maksimale për një projekt ishte 50,000 Euro për 10 muaj.

Megjithatë, përkundër avokimit të vazhdueshëm të shoqërisë civile për krijimin e një skeme të qëndrueshme për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori jo qeveritar për periudha tre vjeçare, as gjatë vitit 2021 ky rekomandim nuk është zbatuar. Konkretisht, është kërkuar që financimi të mos bëhet përmes subvencionimit por përmes blerjes së shërbimeve në periudha tre vjeçare për të eliminuar zbrazëtitë kohore. Lidhur me këtë, organizatat e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale janë shprehur të pakënaqura me thirrjet e MFPT për shkak të kohës së të shkurtër të kohëzgjatjes së projekteve dhe mbështetjes së vogël financiare, sidomos duke pasur parasysh gjendjen e rëndë për shkak të Covid-19. Sipas tyre, kohëzgjatja e shkurtër e thirrjeve të publikuara dhe zbrazëtitë kohore mes thirrjeve të MFPT, po shkaktojnë në vazhdimësi vështirësi në funksionimin e ofruesve të shërbimeve sociale. Kohëzgjatja maksimale e projekteve qoftë edhe prej një viti, konsiderohet shumë e shkurtër dhe e papërshtatshme nga ofruesit e shërbimeve sociale. Këta të fundit, gjatë intervistimit kanë rekomanduar që kohëzgjatja e projekteve të jetë tre vjeçare, për të siguruar kështu funksionim të qëndrueshëm të shërbimeve.

²⁹ Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara nga MPMS në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, 23 Shkurt 2021, <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/thirrja-publike-2/?wpdmdl=12211>

³⁰ Vendim për thirrjen publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të datës 23 Shkurt 2021, 14 Prill 2021, <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/vendim-per-aprovimin-e-ojq-ve-te-licencuara-ne-fushen-e-sherbimeve-sociale/?wpdmdl=12443>

Liridona Zogaj nga Qendra e Kujdesit Ditor “Pema” ka thënë se zakonisht organizatat hartojnë planifikimet strategjike për periudha tre vjeçare dhe shpesh mbesin të pambuluara për shkak të ndërprerjes së financimit apo përfundimit të projektit. Kështu, rrezikohet edhe mbyllja e shërbimeve për periudha të caktuara kohore. Madje, kjo krijon vështirësi edhe për të siguruar bashkë-donatorë sepse për shkak të periudhave të shkurta kohore të financuara nga MFPT dhe komunat, bashkë-donatorët mundtë refuzojnë të financojnë për shkak të pambulueshmërisë së aktiviteteve për periudha të caktuara kohore. Financimi duhet të bëhet me kohë dhe të bëhet për periudha tre vjeçare.³¹

Qendra për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Viktimave të Trafikimit – MVPT është e licencuar të ofrojë strehim dhe shërbime në nivel nacional dhe të trajtojë raste nga i gjithë territori i Kosovës. Teuta Abrashi nga MVPT ka thënë se sa i përket financimit, viti 2021 ka qenë vit më i mirë për shkak se shuma e thirrjes së MFPT ka qenë më e lartë dhe gjithashtu ka pasur edhe një fond emergjent në dy muajt e parë të vitit 2021 për të evituar zbrazëtirën kohore të pambuluar me financim. Sipas saj, në krahasim me vitet paraprake, periudha e pambuluar me financim ka qenë më e shkurtër në vitin 2021. Përkundër mbështetjes nga MFPT dhe nga niveli komunal, ajo ka thënë që është e pamundur të ofrohen shërbime pa ndihmën e një donatori tjetër. Sipas saj, është tejet problematike që çdo vit të sfidohen me problemin e njëjtë dhe një nga mënyrat e zgjidhjes së këtij problemi është përmes lidhjes së kontratave afatgjata me MFPT dhe komunat.³²

Nga tetë intervista me përfaqësues të ofruesve të shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar, gjashtë prej tyre kanë përfituar nga thirrja e MFPT për financim të shërbimeve sociale për vitin 2021. Sipas tyre, mbështetja financiare ka filluar të rritet në dy vitet e fundit, megjithatë buxheti aktual ende nuk i mbulon nevojat e këtyre organizatave për ofrim të shërbimeve cilësore.



MFPT duhet të krijojë një skemë të qëndrueshme për kontraktimin/blerjen e shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori jo qeveritar për periudha tre vjeçare.

³¹ Intervistë me Liridona Zogaj, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën e Kujdesit Ditor “Pema”, 9 Shkurt 2022

³² Intervistë me Teuta Abrashi, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Viktimave të Trafikimit, 1 Shkurt 2022

Të gjithë të intervistuarit për këtë Raport Monitorimi, kanë deklaruar se zgjidhja më e mirë për financimin e shërbimeve sociale është aplikimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Shuma totale e shpenzimeve aktuale për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për QPS-të dhe financimin e institucioneve rezidenciale, është rreth 10 milionë Euro. Rekomandohet që në vitin e parë të zbatimit të Ligjit të ri për Financat e Pushtetit Lokal, shuma totale e ndarë përmes Grantit Specifik të jetë 15 milionë Euro, që i bie që buxheti për shërbime sociale të rritet me 5 milionë Euro.

Financimi i shërbimeve sociale nga niveli komunal gjatë vitit 2021

Financimi për Qendrat për Punë Sociale:

Edhe në vitin 2021, ashtu si në vitet paraprake, në asnjë nga Qendrat e monitoruara nuk ka pasur financim të veçantë nga komunat të dedikuar vetëm për shërbime sociale. Sikurse në vitin 2019 dhe 2020, edhe në vitin 2021 komunat kryesisht kanë mbuluar pagat mujore dhe shpenzimet administrative për Qendrat për Punë Sociale, duke mos ndarë buxhet për QPS-të, për ofrimin e shërbimeve sociale bazuar në nevojat e qytetarëve brenda komunave. Të gjitha komunat pa dallim janë përgjigjur se buxheti aktual nuk plotëson as për së afërmi nevojat reale për shërbime sociale.

Financimi total nga Granti i Përgjithshëm për vitin 2021 për shërbime sociale ishte 7 milionë Euro. Këtu hyjnë kostot e pagave të stafit të QPS-ve dhe shpenzimet e tjera operative. Edhe pse viteve të fundit ka pasur rritje të Grantit të Përgjithshëm, nuk ka pasur rritje të buxhetit për shërbime sociale në komuna. Financimi i shërbimeve sociale nga komunat është ende në nivelin më të ulët të mundshëm.

Sa i përket buxhetit për shërbimet sociale që ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale, më poshtë janë listuar të dhënat për shtatë komunat e monitoruara.

Komuna e Prishtinës nuk ka ndarë financim të veçantë për shërbime sociale për Qendrën për Punë Sociale. E vetmja formë e financimit ka qenë subvencionimi me mjete monetare i familjeve strehuese, familjeve në nevojë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Komuna e Fushë Kosovës sikurse në vitin 2020, edhe në vitin 2021 ka mundur kontraktimin e një psikologu me orar të përgjysmuar (50%) për ofrimin e shërbimeve psikologjike në kuadër të QPS, në shumën prej 150 Euro.

Komuna e Kamenicës nuk ka ndarë financim të veçantë për shërbime sociale për Qendrën për Punë Sociale. E vetmja formë e financimit ka qenë ndihma momentale për familje në nevojë nga Zyra e Kryetarit të Komunës në shumën prej 200 Euro.

Komuna e Prizrenit nuk ka ndarë financim të veçantë për shërbime sociale për Qendrën për Punë Sociale. E vetmja formë e financimit ka qenë financimit për familje strehuese nga Zyra e Kryetarit të Komunës në shumën prej 250 Euro.

Komuna e Lipjanit, Komuna e Pejës dhe Komuna e Ferizajt nuk kanë ndarë buxhet për shërbime sociale për Qendrat për Punë Sociale gjatë vitit 2021.

Blerim Shabani nga Qendra për Punë Sociale në Prishtinë shprehet se vërehet një qasje më e avancuar sa i përket përgjegjësisë të Komunës së Prishtinës. Megjithatë, Komuna ende nuk ka arritur që të financojë shërbimet sociale të QPS në Prishtinë dhe është tejet e nevojshme që të caktohet një fond emergjent për trajtimin e rasteve në QPS. Sipas tij, është e nevojshme që sa më shpejt të procedohet Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, në mënyrë që hyjë në funksion Granti Specifik për Shërbime Sociale i cili do të mundësonte avancimin e shërbimeve sociale.³³

Abaz Xhigoli nga Qendra për Punë Sociale në Fushë Kosovë thotë se në vitin 2021 është vënë re vullnet i shtuar në këtë Komunë sa i përket fokusit në mirëqenie sociale. Ai ka thënë që QPS nuk bën fare kërkesë për buxhet kundrejt Komunës, sepse pavarësisht kërkesave Komuna e ndan buxhetin e caktuar për QPS-të vetëm për paga dhe nevoja administrative.³⁴

Makfirete Shamolli nga Qendra për Punë Sociale në Lipjan, shprehet se buxheti i ndarë për QPS-të është buxhet operativ por jo buxhet për ofrim të shërbimeve.³⁵

Drita Kukaj nga Qendra për Punë Sociale në Pejë, tregon se Komuna nuk ka ndarë buxhet për shërbime sociale dhe se përveç pagave nuk ka pasur mbështetje tjetër. Sipas saj Komuna duhet të përfshijë edhe QPS kur bën planifikimin buxhetor sepse prej vitesh tashmë, buxheti u ofrohet i gatshëm nga Komuna, pa pasur mundësi për ndërhyrje.³⁶

³³ Intervistë me Blerim Shabani, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Prishtinës, 11 Shkurt 2022

³⁴ Intervistë me Abaz Gjigoli, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Fushë Kosovës 2 Shkurt 2022

³⁵ Intervistë me Makfirete Shamolli, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Lipjanit, 10 Shkurt 2022

³⁶ Intervistë me Drita Kukaj, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Pejës, 4 Mars 2022

Edhe Adelina Rexhepi nga Qendra për Punë Sociale në Ferizaj thotë se Komuna e Ferizajt asnjëherë nuk ka ndarë buxhet për shërbime sociale dhe përveç pagave, nuk ka pasur ndonjë mbështetje tjetër.³⁷

Bashkim Rakaj nga Qendra për Punë Sociale në Prizren shprehet se Komuna e orienton buxhetin në investime kapitale. Komuna shpall thirrje vetëm për financimin e shërbimeve nga sektori jo qeveritar. Ai tregon se në rastet emergjente, zyrtarët për punë sociale detyrohen të paguajnë nga xhepi i tyre për nevojat e fëmijëve si bukë, qumësht etj. Kjo për shkak se nuk ka ndonjë fond emergjent për raste të tilla. Ai ka thënë që planifikimi i buxhetit bëhet në nivel të DMS dhe propozimet e QPS-së nuk merren asnjëherë parasysh dhe kështu kërkesat nuk miratohen.³⁸

Të njëjtën gjë e thotë edhe Rifat Hajdari, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Kamenicë, i cili tregon se në raste emergjente punëtorët social paguajnë nga xhepi i tyre, madje duke paguar edhe hotel për strehim emergjent të fëmijëve. Një shqetësim tjetër është mos-pagesa e punëtorëve social në rastet kur janë kujdestarë. Sipas tij, duhet të ekzistojë një stimulim për kujdestaritë.³⁹



Në asnjë komunë të monitoruar nuk ka pasur financim të veçantë për Qendrat për Punë Sociale, të dedikuar vetëm për ofrimin e shërbimeve sociale. Sikurse në dy vitet paraprake, edhe në vitin 2021 komunat kryesisht kanë mbuluar pagat mujore dhe shpenzimet administrative për Qendrat për Punë Sociale. Të gjithë përfaqësuesit e QPS-ve janë përgjigjur që buxheti aktual nuk plotëson as për së afërmi nevojat reale për shërbime sociale.

Të gjithë përfaqësuesit nga Qendrat për Punë Sociale kanë pohuar se zgjidhja më e mirë e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, është Granti Specifik për Shërbime Sociale. Sipas tyre, ky Grant do të ishte i orientuar vetëm për shërbime sociale dhe komuna nuk do të kishte mundësi ta alokojë për shpenzime të fushave të tjera.

³⁷ Intervistë me Adelina Rexhepi, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Ferizajt, 16 Shkurt 2022

³⁸ Intervistë me Bashkim Rakaj, Zyrtar për Shërbime Sociale, Qendra për Punë Sociale në Komunën e Prizrenit, 10 Shkurt 2022

³⁹ Intervistë me Rifat Hajdari, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Kamenicës, 10 Shkurt 2022

Financimi për sektorin jo qeveritar:

Edhe përgjatë vitit 2021, mbështetja e komunave ka vazhduar të bëhet përmes subvencionimit të OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale, e cila nuk është dëshmuar të jetë një formë e qëndrueshme e financimit. Komunitat nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit apo blerjes së shërbimeve sociale.




Nga shtatë komunitat e monitoruara, dy prej tyre nuk kanë shpallur thirrje për financimin e shërbimeve sociale të ofruara nga sektori jo qeveritar, konkretisht Komuna e Ferizajt dhe Komuna e Lipjanit.



Për dallim me vitin 2020, ku tri komunita (Komuna e Prishtinës, Prizrenit dhe Ferizajt) kishin rritur financimin për shërbime sociale nga sektori jo qeveritar, në vitin 2021, vetëm një komunitë ka rritur buxhetin për shërbime sociale për OJQ-të. Komuna e Prishtinës ka rritur për 125% buxhetin për subvencionimin e OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale.

Shuma e financimit për OJQ-të në Komunën e Prishtinës



Gjithashtu, dy komuna që në vitin e kaluar nuk kanë shpallur thirrje për financim të shërbimeve sociale, këtë vit kanë shpallur thirrje në webfaqet e tyre për financim të shërbimeve sociale, konkretisht Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Kamenicës.

Në përgjithësi, thirrjet e publikuara nga komunat për subvencionimin e shërbimeve sociale të ofruara nga sektori jo qeveritar janë shpallur me vonesë, për afërsisht përgjatë muajve Mars – Shtator 2021.

Më poshtë janë paraqitur shumat e ndara për subvencionimin OJQ-ve ofruese të shërbimeve sociale nga komunat:



Komuna e Prishtinës për vitin 2021 ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve për shërbime sociale për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ -ve në kuadër të platformës për mirëqenie sociale “Prishtina e Secilit”, në Shtator 2021.⁴⁰ Shuma totale e kësaj thirrjeje ishte 350,000 Euro. Nga kjo shumë kanë përfituar 24 organizata jo qeveritare.⁴¹ Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohej për çdo projekt individual ishte 500 Euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt ishte 14,000 Euro. Ndërkaq, periudha e zbatimit të projektit ishte maksimumi 12 muaj.

Komuna e Prishtinës në vitin 2019 kandarë 59,650 Euro, në vitin 2020 ka ndarë 155,800 Euro, ndërkaq në vitin 2021 ka pasur rritje prej 125 %, me ndarje prej 350,000 Euro.



Komuna e Prizrenit për vitin 2021 ka shpallur një thirrje publike për financimin e projekteve të OJQ-ve në fushën sociale në Qershor 2021.⁴² Shuma totale e ndarë në kuadër të kësaj thirrjeje ishte 36,500 ku 12 organizata jo qeveritare kanë përfituar nga subvencionimi.⁴³ Në thirrjen e publikuar nga Komuna e Prizrenit, nuk është specifikuar kohëzgjatja e zbatimit të projektit.

Krahasuar me vitin 2020 ku buxheti për financim të sektorit jo qeveritar ishte 90,520 Euro, Komuna e Prizrenit e ka ulur shumën e financimit për OJQ-të për

⁴⁰ Thirrja për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ -ve në shërbim të platformës për mirëqenie sociale Prishtina e Secilit, DMS, Komuna e Prishtinës

⁴¹ Lista e projekteve të vlerësuara/poentuara të thirrjes publike në fushën e mbrojtjes së grupeve të platformës për mirëqenie sociale Prishtina e Secili, Komuna e Prishtinës, https://prishtinaonline.com/uploads/lista_e_projekteve_te_vleresuara_dhe_refuzuara.pdf

⁴² Thirrja për aplikim për projektet e OJQ-ve në fushën e mirëqenies sociale, Komuna e Prizrenit <https://bit.ly/3j7N2zh>

⁴³ Lista e OJQ-ve përfituese në Komunën e Prizrenit, <https://bit.ly/3Jg2QdQ>

shërbime sociale në vitin 2021, në 36,500 Euro, që i bie rreth 60% më pak. Në vitin 2020, Komuna e Prizrenit pati shënuar rritje krahasuar me vitin 2019, ku buxheti në atë kohë ishte 26,100 Euro.



Komuna e Fushë Kosovës për vitin 2021 ka shpallur thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të OJQ-ve në Prill 2021. Kjo thirrje nuk ishte e dedikuar vetëm për shërbime sociale, por në këtë thirrje është përfshirë edhe përkrahja e aktiviteteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe sociale të familjeve dhe individëve në nevojë, lehtësimi i gjendjes së kategorive të personave me nevoja të veçanta si dhe ofrimi i shërbimeve për personat në nevojë. Shuma totale e thirrjes ishte 15,000 Euro. Nga kjo thirrje kanë përfituar 15 organizata jo qeveritare.⁴⁴ Shuma minimale e mbështetjes financiare ishte 500 Euro, ndërsaq shuma maksimale për një projekt ishte 2,000 Euro. Periudha e zbatimit të projektit ishte një ditë deri në gjashtë muaj.

Në vitin 2020 Komuna e Fushë Kosovës nuk kishte shpallur asnjë thirrje për financimin e shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar, ndërsaq në vitin 2019 kishte hapur thirrje publike, por nuk kishte ofruar të dhënat për shumën e buxhetit të ndarë.



Komuna e Kamenicës për vitin 2021 ka shpallur thirrje publike përmes Zyrës së Kryetarit të Komunës për Mbështetjen Financiare Publike të Projekteve të OJQ-ve, në Mars të vitit 2021. Kjo thirrje nuk ishte e dedikuar vetëm për shërbime sociale, në këtë thirrje janë përfshirë fushata avokuese për personat me aftësi të kufizuar, ligjërata dhe trajnime për të drejtat e njeriut, përfshirje në arsim, punësim dhe ofrim të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar, përkrahje e aktiviteteve sportive për personat me aftësi të kufizuar, ofrim i ushtrimeve në fizioterapi për fëmijë me aftësi të kufizuar si dhe ofrim i shërbimeve me mjete ortopedike për persona me aftësi të kufizuara. Shuma totale e thirrjes ishte 10,000 Euro.⁴⁵ Në këtë thirrje ka përfituar një organizatë në shumën prej 9,000 Euro. Periudha e zbatimit të projektit ishte gjashtë muaj. Ndërsaq, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kamenicë nuk ka shpallur thirrje publike për financim të shërbimeve sociale.⁴⁶

⁴⁴ Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të OJQ-ve, DSHMS, Komuna e Fushë Kosovës

⁴⁵ Thirrje për Mbështetjen Financiare Publike të Projekteve të OJQ-ve, Zyra e Kryetarit të Komunës së Kamenicës

⁴⁶ Intervistë me Durim Biqkaj, Zyrtar për Shërbime Sociale, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Kamenicës, 19 Prill 2022

Krahasuar me vitin 2020, ku përmbajtja e thirrjes ka qenë e paqartë dhe i është dedikuar projekteve sportive⁴⁷, në vitin 2021 kjo komunë ka financuar një organizatë për ofrim të shërbimeve sociale.



Komuna e Pejës nuk ka kthyer përgjigje lidhur me financimin e shërbimeve sociale për sektorin jo-qeveritar dhe nuk është gjetur asnjë thirrje e publikuar nga kjo Komunë në webfaqen e Komunës.

Komuna e Pejës për vitin 2020 kishte shpallur një thirrje publike për subvencionimin e OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale, në shumën prej 80,000 Euro. Ndërkaq për vitin 2019, kjo Komunë nuk pati ofruar informacion mbi shumën e ndarë për subvencionimin e OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale.



Komuna e Lipjanit për vitin 2021 nuk ka shpallur thirrje për financimin e shërbimeve sociale. Kjo Komunë, përmes Zyrës së Kryetarit të Komunës ka subvencionuar strehimoren për rastet e dhunës në vlerë prej 2,830 Euro. As në vitin 2020, Komuna e Lipjanit nuk kishte shpallur thirrje publike për subvencionimin e shërbimeve sociale nga OJQ-të, mirëpo kishte subvencionuar përmes Zyrës së Kryetarit strehimoren për rastet e dhunës në vlerë prej 3,000 Euro. Gjithashtu, përmes Zyrës së Kryetarit gjatë vitit 2020, kjo Komunë ka ndarë 7,200 Euro si mbështetje gjatë pandemisë për fëmijët pa përkujdes prindëror. Thirrja e fundit e shpallur nga kjo Komunë ishte në vitin 2019, ku DSHMS në Lipjan kishte hapur thirrje publike dhe kishte ndarë 5,000 Euro për organizatat jo qeveritare në fushën sociale.⁴⁸



Komuna e Ferizajt nuk ka shpallur thirrje për financimin e shërbimeve sociale për vitin 2021. Në vitin 2020, Komuna e Ferizajt kishte pasur rritje të buxhetit prej 128% për shërbime sociale në krahasim me vitin 2019. Në vitin 2020, përmes thirrjes publike kjo komunë ka ndarë 30,000 Euro, ndërkaq në vitin 2019, kandarë 13,125 Euro. Sipas udhëheqëses së shërbimeve sociale në këtë Komunë, buxheti i Komunës për vitin 2021 ka qenë tejet i limituar, duke pamundësuar kështu ndarjen e buxhetit për shërbime sociale.⁴⁹ Lidhur me vështirësitë e Komunës për financim, Drejtoresha e Handikos në Ferizaj ka thënë që mjetet e shpalljes së vitit 2020 nuk janë alokuar në atë vit për shkak të pandemisë dhe të njëjtat janë rialokuar në vitin 2021. Ndërkaq, në vitin 2021 ato nuk kanë marrë asnjë mbështetje financiare nga komuna.⁵⁰

⁴⁷ Shërbimet Sociale në Kohë Pandemie, KOMF, Prill 2021, https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-i-Monitorimit-2021-Shqip_compressed.pdf

⁴⁸ Të dhëna nga Makfirete Shamolli, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Lipjanit, 5 Maj 2022

⁴⁹ Intervistë me Emira Sallahu, Udhëheqëse e Sektorit për Mirëqenie Sociale, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Ferizajt, 3 Shkurt 2022

⁵⁰ Intervistë me Xhemile Murseli, Drejtoreshë Ekzekutive në Handikos Ferizaj, 9 Shkurt 2022

Përkundër rekomandimeve nga raportet e kaluara, as në vitin 2021 komunat nuk kanë krijuar skemë të qëndrueshme të blerjes apo kontraktimit afatgjatë të shërbimeve të OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale, duke cenuar kështu cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve sociale. Forma e financimit ka vazhduar të bëhet në formë të subvencionimit, pa bërë analizë paraprake të nevojave të komunitetit. Në asnjë nga komunat e monitoruara nuk është bërë analizë në terren për numrin e personave në nevojë dhe llojet e shërbimeve që duhen ofruar. Në të gjitha komunat e monitoruara, përfaqësues nga Drejtoritë Komunale për Mirëqenie Sociale kanë pohuar se të gjitha informacionet për personat në nevojë i marrin nga Qendrat për Punë Sociale në bazë të rasteve të raportuara, dhe aktualisht nuk kanë kapacitete të bëjnë një hulumtim të tillë. Prandaj, thirrjet e komunave vazhdojnë të bëhen ad-hock dhe me shuma të caktuara paraprakisht të cilat nuk përkojnë me nevojat dhe strategjitë e organizatave jo qeveritare që ofrojnë shërbime sociale dhe nuk adresojnë nevojat reale të komunitetit.

Komunat deri tani nuk kanë krijuar një model të thirrjeve publike për financim të shërbimeve sociale i cili përmban kërkesat themelore për financim. Gjithashtu, thirrjet e shpallura nga komunat e monitoruara nuk u janë dedikuar ekskluzivisht vetëm OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale. Disa nga to (gjej në sektorin më lart), përfshinin edhe OJQ të fushë-veprimtarive të tjera sikurse arsimi, aftësimi profesional e sportit. Përveç kësaj, edhe këtë vit janë financuar edhe OJQ që nuk janë të licencuara në shërbime sociale. Kjo për shkak se në disa nga thirrjet e shpallura nuk është përcaktuar si kriter licencimi i OJQ-ve për shërbime sociale. Në katër thirrjet e analizuara, vetëm Komuna e Prizrenit ka vendosur si kriter licencimin e OJQ-ve nga Ministria përkatëse, ndërsa Komuna e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Kamenicës nuk kanë specifikuar si kriter licencimin e organizatave.



Mungesa e kriterit të licencimit për ofrimin e shërbimeve sociale në thirrjet për financim të komunave ka krijuar pakënaqësi mes ofruesve të licencuar të cilët i janë përmbajtur rigorozisht procesit të licencimit sistematik. Gjithashtu, një gjë e tillë ul cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe cenon procesin e monitorimit dhe inspektimit të cilët po ashtu synojnë ruajtjen e standardeve cilësore në ofrimin e shërbimeve sociale.

Ndër shqetësimet kryesore të ofruesve të shërbimeve nga sektori jo qeveritar, janë shuma e ulët e financimit të shërbimeve dhe kohëzgjatja e shkurtë e zbatimit të projekteve. Edhe pse përgjatë tre viteve të fundit, në disa komuna është vënë re një rritje e shumës së financimit, shërbimet sociale vazhdojnë të përballen me mungesë të buxhetit të qëndrueshëm.

Komunat kryesisht e ndajnë buxhetin në mënyrë proporcionale për organizatat që kanë aplikuar, pavarësisht llojit, kostos të shërbimit apo përfituesve. Forma e tillë e financimit cenon tregun e konkurrencës së ndershme dhe vlerave mes OJQ-ve duke dëmtuar cilësinë e shërbimeve sociale. Bazuar në thirrjet e shpallura nga komunat e monitoruara, mesatarja e zbatimit të projekteve nga këto thirrje është gjashtë muaj.

Kjo është një periudhë tejet e shkurtër për të implementuar një projekt, madje rëndon edhe më shumë gjendjen e personave në nevojë duke u detyruar që herë pas here të ndërpresin shërbimet për shkak të përfundimit të projekteve. Përveç kësaj, aplikimi i shpeshtë i ofruesve në thirrjet e shpallura, merr një kohë të konsiderueshme dhe energji të stafit. Sipas të intervistuarve, në vend që kjo energji e stafit të shfrytëzohet për ofrimin e shërbimeve cilësore, duhet që disa herë në vit ata të fokusohen dhe të merren me aplikime në thirrjet e shpallura si në nivelin komunal ashtu edhe në nivelin qendror. Sipas Drejtorit për Politika Sociale dhe Familjare në MFPT, këtë vit është planifikuar plotësim-ndryshimi i rregullores për mbështetjen e OJQ-ve përmes subvencionimit, me anë të së cilës krijohet mundësia që të përcaktohet periudha kohore e implementimit të projekteve dhe ku po synohet që financimi të bëhet në periudha tre vjeçare. Në anën tjetër, në vitin 2022 synohet të hartohet edhe akti nënligjor që rregullon kontraktimin e shërbimeve nga sektori jo qeveritar.⁵¹

Organizata Handikos në Kamenicë ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë kryesisht ofrimin e mjeteve ortopedike, avokim dhe lobim. Hyrmete Morina nga Handikos në Kamenicë, theksoi që në katër muajt e fundit nuk kanë projekt dhe financim as nga niveli qendror dhe as nga niveli komunal, meqenëse projekti i fundit ka qenë i financuar nga Komuna me kohëzgjatje prej gjashtë muaj, ka përfunduar në Tetor 2021. Prandaj, kjo ka bërë që të mbyllen shërbimet për një kohë të caktuar, siç ndodh edhe në raste të tjera, dhe të reagohet vetëm në raste emergjente. Ajo është shprehur që këto zbrazëtira kohore përveç të tjerash po ndikojnë edhe në humbjen e kontakteve me përfitues. Sipas saj, sfida kryesore është financimi i qëndrueshëm i shërbimeve sociale dhe mungesa e kapaciteteve njerëzore, ku në këtë qendër punojnë vetëm tre persona staf.⁵²

⁵¹ Intervistë me Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 28 Shkurt 2022

⁵² Intervistë me Hyrmete Morina, Drejtoreshë Ekzekutive në Handikos Kamenicë, 3 Mars 2022

Organizata Autizmi në Prishtinë ofron shërbime në tre programe. Programi për intervenim të hershëm, programi për përgatitje për shkollë si dhe programi për pavarësim dhe aftësim profesional për adoleshentët me autizëm. Aida Topanica nga Autizmi, vlerëson faktin që në vitin 2021, thirrja e shpallur nga Komuna e Prishtinës ka qenë e dedikuar për shërbime sociale, megjithatë sipas saj buxheti aktual i organizatës nuk i mbulon nevojat e organizatës dhe nuk siguron qëndrueshmëri financiare. Një shqetësim tjetër është edhe mungesa e informimit të saktë dhe me kohë në momentin kur shpallen thirrjet nga Komuna, ku mënyra e vetme e informimit është përmes përcjelljes së vazhdueshme të shpalljeve në webfaqen e komunës.⁵³

Organizata Down Syndrome Kosova ka dy programe, atë për intervenim dhe edukim të hershëm dhe programi për autonomi dhe aftësim profesional. Aktualisht kjo organizatë ka të regjistruar 300 përfitues të shërbimeve. Ermira Shabani nga DSK Kosova, ka thënë që është vënë re një përmirësim në Komunën e Prishtinës sa i përket fushës sociale, ku ka një fokus më të madh në krahasim me vitet e tjera. Sipas saj, ajo çka mbetet për tu përmirësuar është të bëhet një analizë e nevojave të personave në nevojë për shërbime sociale dhe më pas të shpallen thirrjet konform kësaj analize. Megjithatë, sfida kryesore për DSK Kosova mbetet sigurimi i shërbimeve sociale për shkak të mungesës së financimit.⁵⁴

Qendra e Kujdesit Ditor “Pema” ofron shërbime ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara në bazë në komunitet në Komunën e Prizrenit, Pejës, Ferizajt dhe Gjilanit. Liridona Zogaj nga “Pema” ka potencuar që disa komuna kanë filluar gradualisht ndër vite që të shpallin thirrje për financim të shërbimeve sociale dhe se ka një mobilizim më të mirë në këtë drejtim. Megjithatë, duhet të ekzistojnë standardet e financimit apo formula e financimit dhe të caktohet kosto vjetore e shpenzimeve për ofrim të shërbimeve sociale nga sektori jo qeveritar. Shqetësimi kryesor janë zbrazëtirat kohore në mes të thirrjeve, duke qenë se po rrezikojnë mbylljen e përkohshme të shërbimeve.⁵⁵

Organizata Handikos në Ferizaj ofron shërbime multidisciplinare në bazë në komunitet dhe shërbime në shtëpi. Xhemile Murseli nga Handikos në Ferizaj ka deklaruar që Komuna e Ferizajt nuk ka interesim për mbështetje të shërbimeve sociale në përgjithësi. Sa i përket thirrjeve të shpallura nga Komuna, ajo është shprehur që nuk ka rivlerësim të kriterëve të thirrjeve dhe organizatat nuk vlerësohen nëse i kanë përmbushur standardet për të ofruar shërbime sociale. Ndërsa as financimi nga niveli qendror sipas saj nuk bëhet duke u bazuar

⁵³ Intervistë me Aida Topanica, Udhëheqëse e Departamentit të Projekteve në OJQ Autizmi në Prishtinë, 2 Shkurt 2022

⁵⁴ Intervistë me Ermira Shabani, Udhëheqëse Nacionale e Programit të Shërbimeve në Down Syndrome Kosova, 3 Shkurt 2022

⁵⁵ Intervistë me Liridona Zogaj, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën e Kujdesit Ditor “Pema”, 9 Shkurt 2022

në nevojat dhe projektet e organizatave, duke qenë se zakonisht projektet aprovohen me aktivitete ashtu siç janë, ndërkaq buxheti i propozuar në këto projekte përgjysmohet.⁵⁶


Organizata ORA Akti në Fushë Kosovë është duke zhvilluar një projekt për identifikimin e hershëm të viktimave potenciale të trafikimit në Gjilan, Ferizaj dhe në Fushë Kosovë duke ofruar mbështetje përmes punëtorëve social. Rexhep Gojnovci nga kjo organizatë ka thënë që nuk kanë aplikuar në asnjë nga thirrjet e hapura (as në thirrjen e MFPT dhe as në thirrjen e komunës) dhe se këto thirrje bëhen pa ndonjë analizë mbi nevojat. Sipas tij, duhet të bëhet një planifikim i mirëfilltë i shpenzimeve dhe aktiviteteve si dhe të gjinden mënyra që me fillimin e aplikimit të Grantit Specifik, ky Grant të përdoret vetëm për shërbime sociale, pa u kanalizuar në fusha të tjera. Përveç kësaj, Komunat duhet të identifikojnë partnerët e bashkëpunimit në mënyrë që të mbulojnë shërbimet që nuk mund t'i mbulojë komuna.⁵⁷

Organizata NOPM në Kamenicë ofron trajnime për zyrtarë komunal, qytetarë dhe OJQ në fushën e edukimit. Kjo organizatë për shkak të mungesës së financimit për shërbime sociale, është detyruar që të orientojë veprimtarinë e saj në fusha të tjera. Besime Tusha nga NOPM ka thënë që Komuna e Kamenicës zakonisht shpall thirrje të hapur apo publike për aplikim për organizata që ofrojnë shërbime, mirëpo problemi qëndron se në këtë komunë nuk ka shumë organizata që ofrojnë shërbime sociale apo që janë të licencuara për shërbime sociale. Edhe Tusha mendon që sfida kryesore është qëndrueshmëria financiare e organizatave.⁵⁸

⁵⁶ Intervistë me Xhemile Murseli, Drejtoreshë Ekzekutive në Handikos Ferizaj, 9 Shkurt 2022

⁵⁷ Intervistë me Rexhep Gojnovci, Drejtor Ekzekutive në OJQ ORA - Akti, 3 Shkurt 2022

⁵⁸ Intervistë me Besime Tusha, Drejtoreshë Ekzekutive në NOPM, 15 Shkurt 2022



KAPACITETET E KOMUNAVE PËR SHËRBIME SOCIALE

KAPACITETET E KOMUNAVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Komunat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale brenda territorit të tyre, sipas standardeve dhe politikave të Qeverisë ose ministrive përkatëse.⁵⁹ Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë përgjegjëse për çështjet komunale të mirëqenies sociale dhe menaxhojnë Qendrat për Punë Sociale. QPS-të janë institucione publike që kanë përgjegjësi të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për personat në nevojë. Të gjitha komunat e Kosovës kanë Qendra për Punë Sociale. Në total, në territorin e Kosovës janë 40 Qendra për Punë Sociale me rreth 400 punëtorë social.

Kapacitetet e Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në menaxhimin e shërbimeve sociale

Gjatë vitit 2021, kapacitetet e komunave për menaxhim dhe ofrim të shërbimeve sociale kanë vazhduar të jenë të mangëta sikur në dy vitet paraprake.

Nga komunat e monitoruara, Komuna e Prishtinës, Komuna e Prizrenit dhe Komuna e Pejës (kjo e fundit nga viti 2021) kanë Drejtoritë Komunale për Mirëqenie Sociale si drejtori të ndara. Ndërkaq në katër komunat e tjera ky dikaster funksionon bashkë me Drejtorinë për Shëndetësi. Kjo është konsideruar nga të intervistuarit, si një ndër arsytet e mungesës së fokusit në sektorin e mirëqenies sociale, duke qenë se rëndësia më e madhe i kushtohet sektorit të shëndetësisë, e në këtë rast edhe buxheti dedikohet në këtë sektor.

Më 17 Tetor 2021, u mbajtën Zgjedhjet Lokale ku në shtatë komunat e monitoruara, pati ndryshime në Drejtoritë Komunale për Mirëqenie Sociale dhe tashmë janë zgjedhur drejtorët e rinj të cilët e kanë marrë detyrën deri në fillim të vitit 2022. Ndryshimet në udhëheqje kanë ndikuar në organizimin e punës nëpër komuna dhe zvarritje në procesin e punës. Vetëm në Komunën e Ferizajt, brenda katër viteve janë ndërruar tre drejtorë të mirëqenies sociale, gjë që ka sjellë vështirësi në adaptimin e stafit dhe shtyrjen e proceseve përpara lehtësisht.⁶⁰

⁵⁹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare

⁶⁰ Intervistë me Emira Sallahu, Udhëheqëse e Sektorit për Mirëqenie Sociale, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Ferizajt, 3 Shkurt 2022

Sipas ofruesve të shërbimeve sociale, ndryshimet e shpeshta politike kanë zvarritur në masë të madhe procesin e decentralizimit për shkak të ndërprerjes së proceseve në përgjithësi. Liridona Zogaj nga Qendra e Kujdesit Ditor “Pema” mendon që në ato komuna që nuk ka pasur ndryshime të shpeshta të udhëheqësve të komunës, ata në fund kanë arritur ta kuptojnë procesin e decentralizimit dhe rëndësinë e shërbimeve sociale.⁶¹

Të gjithë drejtorët e zgjedhur janë pyetur për planifikimet për mandatin e ardhshëm lidhur me decentralizimin dhe organizimin e shërbimeve sociale. Konkretisht në pyetjen se a planifikoni të organizoni një hulumtim në terren për nevojat e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale, Adelina Sahiti, Drejtoreshë për Mirëqenie Sociale në Komunë në Prishtinë, ka thënë që brenda vitit të parë do të realizohet një hulumtim në terren për nevojat e qytetarëve për shërbime sociale.⁶² Në Komunën e Prizrenit, Vjollca Kabashi, Drejtoreshë për Mirëqenie Sociale ka thënë që në këtë komunë veçse ka filluar të realizohet një hulumtim i tillë.⁶³ Ndërkaq, ndryshe mendon Shkëlzen Hajdini, Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Lipjanit, i cili ka thënë që ka nevojë për qasje multisektoriale dhe një hulumtim i tillë nuk duhet të lihet vetëm në kompetencat e komunës ose QPS. Prandaj, gjatë vitit të parë të mandatit, nuk është e paraparë një gjë e tillë.⁶⁴

Sikurse në dy vitet paraprake, mungesa e stafit profesional në shërbime sociale brenda DSHMS është raportuar si vështirësi kyçe në menaxhimin e shërbimeve. Në DSHMS në Lipjan nuk ka staf të posaçëm për mirëqenie sociale dhe ekipi përbëhet nga dy juristë.⁶⁵ Komuna e Prizrenit edhe pse e ka të ndarë Drejtorinë për Mirëqenie Sociale, konsiderohet se kjo Drejtori nuk ka staf profesional në shërbime sociale. Në DMS në Prizren stafi përbëhet nga Drejtori, Koordinator dhe Asistenti.⁶⁶ Ndërkaq, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Ferizaj ka staf të profilizuar për mirëqenie sociale, duke qenë se përbëhet nga Drejtori, dy Shefa të sektorit (një për shëndetësi dhe një për mirëqenie sociale) dhe Asistenti Financiar/Administrativ. Megjithatë përfaqësues nga kjo Drejtori konsiderojnë që numri i stafit nuk është i mjaftueshëm.⁶⁷ Njësoj mendojnë edhe përfaqësues nga Drejtoria për Shëndetësi

⁶¹ Intervistë me Liridona Zogaj, Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën e Kujdesit Ditor “Pema”, 9 Shkurt 2022

⁶² Intervistë me Adelina Sahiti, Drejtoreshë për Mirëqenie Sociale, Komuna e Prishtinës, 14 Mars 2022

⁶³ Intervistë me Vjollca Kabashi, Drejtoreshë për Mirëqenie Sociale, Komuna e Prizrenit, 28 Mars 2022

⁶⁴ Intervistë me Shkëlzen Hajdini, Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Lipjanit, 22 Mars 2022

⁶⁵ Intervistë me Shkëlzen Hajdini, Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Lipjanit, 22 Mars 2022

⁶⁶ Intervistë me Vjollca Kabashi, Drejtoreshë për Mirëqenie Sociale, Komuna e Prizrenit, 28 Mars 2022

⁶⁷ Intervistë me Emira Sallahu, Udhëheqëse e Sektorit për Mirëqenie Sociale, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Ferizajt, 3 Shkurt 2022

dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Fushë Kosovës, të cilët përkundër faktit që në Drejtori ekziston një zyrtar për mirëqenie sociale, konsiderojnë që numri i stafit në Drejtori është i vogël për menaxhim dhe monitorim cilësor të shërbimeve.⁶⁸ Në Komunën e Prishtinës numri i stafit në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale është tetë dhe ekziston stafi i profilizuar në shërbime sociale, mirëpo ka nevojë për kapacitete shtesë të burimeve njerëzore meqenëse në kryeqytet nevoja për shërbime sociale është tejet e madhe.⁶⁹ Komuna e Kamenicës edhe pse konsiderohet si një komunë me territor të madh dhe probleme të shumta sociale në disa komunitete që jetojnë në këtë komunë, kapacitetet e DSHMS vazhdojnë të mbesin të ulëta. Numri i stafit në DSHMS është tre zyrtarë, ku përfshihen një jurist, një ekonomist dhe një sociolog. Vlen të ceket që kjo Komunë ka një zyrtar për shërbime sociale, mirëpo nuk ka kapacitete të mjaftueshme për prokurimin dhe kontraktimin e shërbimeve sociale.⁷⁰

Sfidë tjetër është mungesa e planifikimeve të shërbimeve dhe planifikimeve buxhetore bazuar në nevojat. Në asnjë nga komunat e monitoruara, nuk është bërë planifikim buxhetor bazuar në ndonjë analizë paraprake të nevojave në baza vjetore, për shërbime sociale. Planifikimi buxhetor i komunave është i prirur të përsërisë planifikimet buxhetore paraprake, pa ndonjë vlerësim real mbi nevojat e qytetarëve për shërbime sociale. Për më tepër, ky planifikim nuk merr për bazë as nevojat e QPS-ve dhe OJQ-ve ofruese të shërbimeve sociale në komuna. Deri më tani në asnjë komunë nuk është bërë identifikim i nevojave dhe planifikim buxhetor i bazuar në këto nevoja. Në anën tjetër, edhe në rast të kërkesave të QPS-ve, buxheti i ndarë për këto qendra menaxhohet nga DSHMS dhe nuk bartet në QPS.

⁶⁸ Intervistë me Mimoza Shala Kolshi, Drejtoreshë dhe Hysen Sllamniku, Zyrtar për Mirëqenie Sociale në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Fushë Kosovës, 1 Mars 2022

⁶⁹ Intervistë me Adelina Sahiti, Drejtoreshë për Mirëqenie Sociale, Komuna e Prishtinës, 14 Mars 2022

⁷⁰ Intervistë me Durim Biqkaj, Zyrtar për Shërbime Sociale, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Kamenicës, 19 Prill 2022

Kapacitetet e Qendrave për Punë Sociale në ofrimin e shërbimeve sociale

Për dallim nga viti 2020 kur për shkak të ngarkesës me rastet gjatë pandemisë Covid-19 si dhe stafit të limituar fokusi i punës nuk ka qenë drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve sociale, në vitin 2021 ka pasur një adaptim me situatën pandemike dhe puna ka vazhduar më normalisht. Përkundër kësaj, stafi profesional për shërbime sociale vazhdon të jetë i ulët dhe në disproporcion me numrin e rasteve në nevojë.

Numri i vogël i zyrtarëve u raportua si sfida kryesore në Qendrat për Punë Sociale. Në QPS në Prishtinë janë gjithsej 13 zyrtarë për shërbime sociale. Ky është një numër tejet i ulët në krahasim me numrin e rasteve në nevojë për shërbime sociale në këtë Komunë.⁷¹



Në QPS në Prishtinë, edhe në vitin 2021 ka pasur rast kur 230 raste aktive janë menaxhuar vetëm nga një zyrtar për shërbime sociale, gjë që është në kundërshtim me standardet minimale.

Në Komunën e Prizrenit gjatë vitit 2021 ishin 11 zyrtarë për shërbime sociale, ku tre prej tyre janë pensionuar, përderisa vendet e tyre të punës nuk janë plotësuar ende me staf të ri. Mesatarja e trajtimit të rasteve nga një zyrtar i shërbimeve sociale në QPS në Prizren, është 170 raste.

Edhe në Qendrën për Punë Sociale në Pejë, konsiderohet që numri i punëtorëve social është shumë i vogël. Në këtë QPS momentalisht janë shtatë punëtorë në shërbime sociale.⁷² Në Qendrën për Punë Sociale në Kamenicë, edhe për shkak të natyrës së komunës ku jetojnë disa komunitete, ka mbingarkesë të madhe të rasteve dhe numër të vogël të stafit. Drejtori i QPS thotë se Qendra ka mungesë të dy zyrtarëve për shërbime sociale, por Komuna ende nuk ka shpallur konkurs për plotësimin e këtyre dy vendeve.⁷³

Për shkak të kufizimeve në burime njerëzore dhe financiare, shërbimet sociale janë të fokusuara në ofrimin e shërbimeve emergjente të mbrojtjes dhe ka mungesë të ofrimit të shërbimeve të parandalimit dhe re-integritit, të cilat janë të domosdoshme për mirëqenien e fëmijëve dhe personave në nevojë. Për më tepër për disa prej fëmijëve apo personave në nevojë për shërbime sociale, sistemi nuk ofron asnjë shërbim, si për shembull për fëmijët apo personat viktimë të

⁷¹ Intervistë me Blerim Shabani, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Prishtinës, 11 Shkurt 2022

⁷² Intervistë me Drita Kukaj, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Pejës, 4 Mars 2022

⁷³ Intervistë me Rifat Hajdari, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Kamenicës, 10 Shkurt 2022

abuzimit me substanca narkotike, fëmijët e përfshirë në punë të rënda etj.

Raporti i Monitorimit të KOMF tregon që edhe gjatë vitit 2021, QPS-të kanë vazhduar të kenë qasje reaktive sa i përket matjes së cenueshmërisë në komunat ku veprojnë. Asnjë QPS në komunat e monitoruara, nuk ka pasur mundësi dhe kapacitet që të dalë në terren dhe të bëjë vlerësimin e qytetarëve në nevojë.

Bazuar në të dhënat e monitorimit, nuk respektohet parimi i punës multidisiplinare i cili është një parim themelor për QPS-të, duke qenë se QPS-të nuk kanë në përbërje profesionistë nga lëmi të ndryshme të kërkuara edhe me ligj sikurse zyrtarë për shërbime sociale, psikologë, pedagogë, sociologë dhe juristë. Zyrtarët për shërbime sociale nuk janë të profilizuar dhe si pasojë punojnë me të gjitha lëndët dhe kategoritë në nevojë.

Përveç nevojave për kapacitete financiare dhe njerëzore, stafi i QPS-ve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve sociale, ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm profesional.



Sikurse në dy vitet paraprake, nuk ka pasur plan vjetor të trajnimeve të dizajnuar nga MFPT, përkundër faktit që kërkesë e standardeve minimale është mbajtja e trajnimeve të rregullta vjetore për secilën kategori. Përveç kësaj, nuk ka programe të akredituara të trajnimeve për shërbime sociale.

Poashtu, të gjeturat nga monitorimi tregojnë që QPS-të nuk janë të përgatitura për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për shërbime sociale. Në të gjitha komunat evidentohet mungesa e aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim të buxhetit, mungesa e vlerësimit të nevojave në territoret respektive si dhe bashkëpunimi i mirëfilltë në mes të QPS-ve dhe DSHMS-ve për hartim të një planifikimi buxhetor të përbashkët konform këtyre nevojave.

Duke qenë se pas implementimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale, buxheti pritët t'i bartet QPS-ve, ato duhet të jenë të përgatitura për pranimin e kompetencave për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për ofrimin e shërbimeve sociale.



Në asnjë nga komunat e monitoruara, nuk ka pasur rast kur kërkesat e Qendrave për Punë Sociale janë marrë për bazë nga DSHMS-të. Madje, përfaqësuesit nga QPS-të kanë pohuar që komunat nuk i konsultojnë ata gjatë planifikimit buxhetor për shërbime sociale.



RAPORTIMI

RAPORTIMI

Sipas të dhënave të monitorimit, akoma nuk ka protokolle të qarta dhe formate të caktuara të raportimit për të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale.

Njësoj si në dy vitet paraprake, të intervistuarit kanë deklaruar që raportojnë në të dy nivelet, qendror dhe komunal, duke dërguar kështu raporte të ndryshme në MFPT dhe DSHMS. Në të dy nivelet, ofruesit bëjnë raportim të rregullt periodik mbi rastet. Në DSHMS bëhet raportim mbi informata më të përgjithshme që lidhen me llojet e klientëve, shërbimeve, sfidat e QPS-ve etj. Ndërkaq, në MFPT, QPS-të vazhdojnë të raportojnë të dhënat e detajuara mbi rastet e trajtuara. Shumë prej ofruesve të shërbimeve sociale, e konsiderojnë se po bëjnë punë të dyfishtë duke raportuar në të dyja nivelet. Por sipas Makfirete Shamollit nga QPS në Lipjan, duhet të sigurohet zbatimi i dispozitave në fuqi të LSHSF sa i përket mënyrës së raportimit vjetor, dhe atë në të dy nivelet e Qeverisjes. Bashkim Rakaj nga QPS në Prizren, konsideron që QPS-të nuk e kanë obligim raportimin në MFPT, meqenëse me decentralizim të shërbimeve Komuna (DSHMS) është ajo që duhet të raportojë në MFPT.⁷⁴

Drejtori i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes, Mentor Morina, mendon që ndarja jo e qartë e kompetencave ka bërë që të kemi raportim të dyfishtë. Sipas tij, për të rregulluar çështjen e raportimit, ministria ka nisur një akt nënligjor. Në përgjithësi, përfaqësues nga komunat e monitoruara mendojnë që çështja e raportimit duhet të rregullohet me Ligjin e ri apo përmes udhëzimeve administrative, në mënyrë që të shmanget dyfishimi i punës dhe rregullimi i linjës së raportimit.

Edhe pas 12 vitesh nisje të procesit të decentralizimit, QPS-të hezitojnë të bëjnë ndarjen e të dhënave me komunën e cila tashmë është përgjegjëse e drejtpërdrejtë për ofrimin e shërbimeve brenda territorit të saj, ndërkohë që bëjnë raportim të detajuar për ministrinë.

Ajo çka konsiderohet problematike nga të intervistuarit, është komunikimi dhe bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Drejtorive Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Bazuar në intervistat e realizuara, bashkëpunim më të madh ka në mes të QPS-ve dhe MFPT se sa në mes të DSHMS-ve dhe MFPT. Ekziston një hendek i madh komunikimi në mes të nivelit qendror dhe atij komunal. Është më se i domosdoshëm rregullimi i raportimit në nivel horizontal dhe vertikal, standardizimi i formave të raportimit dhe ndarja e të dhënave, duke pasur parasysh ruajtjen e konfidencialitetit.

⁷⁴ Intervistë me Makfirete Shamolli nga QPS në Lipjan dhe Bashkim Rakaj nga QPS në Prizren, 10 Shkurt 2022

Sa i përket raportimit të ofruesve nga sektori jo qeveritar, OJQ-të kanë deklaruar se nuk ekziston ndonjë linjë e raportimit as në nivelin qendror dhe as në atë komunal, në rastet kur ato nuk financohen nga institucionet publike. Në të shumtën e rasteve, përfaqësues nga OJQ-të ofruese të shërbimeve sociale, gjatë monitorimit kanë deklaruar se financohen nga donatorë jo qeveritarë, prandaj raportimi bëhet vetëm ndaj donatorëve.

Çështje tjetër e paqartë mbetet ruajtja e të dhënave personale të përfituesve. Ofruesit e shërbimeve e kanë të paqartë nëse të dhënat e përfituesve mund të ndahen edhe me komunën, konkretisht me Drejtorinë për Mirëqenie Sociale.

Sa i përket pjesës teknike, baza e të dhënave për shërbime sociale e menaxhuar nga MFPT vazhdon të mos jetë e digjitalizuar dhe të dhënat dërgohen fizikisht përmes USB ose në formë elektronike përmes postës elektronike.



INSPEKTIMI, MONITORIMI DHE LICENCIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE

INSPEKTIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Sipas Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2013, nenit 19 të tij “Monitorimi dhe Inspektimi”, monitorimi dhe inspektimi bëhen nga niveli qendror, kështu që mandati për monitorimin dhe inspektimin e shërbimeve sociale mbetet kompetencë e Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF) në kuadër të MFPT.



Në vitin 2021 Njësia për Monitorim dhe Inspektim në kuadër të MFPT ka kryer në total pesë inspektime, të cilat janë bërë nga dy zyrtarë sa janë në total në këtë Njësi. Në vitin 2020 ishin tre zyrtarë për inspektim, por për shkak të largimit të njërit zyrtar, tashmë kanë mbetur vetëm dy pasi vendi i punës nuk është plotësuar.

Njësia për Monitorim dhe Inspektim përballet me probleme të funksionimit, siç janë numri i vogël i zyrtarëve për inspektim, kushtet minimale për funksionim, mungesa e aftësisë profesionale të stafit dhe mungesa e udhëzuesve për inspektim. Sipas vlerësimit të zyrtarëve të kësaj Njësie, numri i zyrtarëve për inspektim duhet të rritet deri në shtatë persona për të përmbushur nevojat e Njesisë.

Kjo Njësi është përgjegjëse për inspektimin e rreth 40 QPS-ve në 38 komuna, Institutin Special në Shtime, Shtëpinë me Bazë në Komunitet për Fëmijë në Shtime, Shtëpinë e Personave të Moshuar në Prishtinë, Strehimoren për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit në Lipjan, Shtëpitë me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuar në 12 komuna, Shtëpitë me Bazë në Komunitet për Personat e Moshuar në katër komuna dhe 48 OJQ të licencuara që ofrojnë shërbime sociale.

Problem tjetër i funksionit të inspektimit ka të bëjë me përcaktimin e mandatit dhe kompetencave të kësaj Njësie. Sipas Zyrtarëve të Lartë për Monitorim dhe Inspektim në MPFT, Fitore Rexhaj, Njësia për Monitorim dhe Inspektim të Shërbimeve Sociale dhe Familjare duhet të jetë e ndarë dhe e pavarur nga Divizionet aktuale, dhe të krijohet si trupë e pavarur për inspektim. Ajo konsideron që funksionimi aktual i Njesisë për Monitorim dhe Inspektim, mund të paraqesë konflikt interesi sepse në shumë raste njësia bën inspektim të divizioneve të vetvetes. Sipas saj, monitorimi duhet të ndahet dhe Njësia aktuale të shndërrohet në Njësi për Inspektim të Shërbimeve Sociale. Edhe pse emërtimi i kësaj njësie përmban edhe emrin “monitorim”, gjatë vitit 2021 kjo Njësi nuk ka realizuar proces të monitorimit për shërbime

sociale, kjo pasi që monitorimi realizohet nga zyrtarët kompetent sipas detyrës zyrtare për shërbime (kategori) të caktuara sociale në kuadër të Divizionit të Shërbimeve Sociale (DSHS) dhe Divizionit për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Persona të Moshuar (DAKPM) në Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes (DPSF).

Praktikat ndërkombëtare tregojnë se monitorimi dhe inspektimi i ofruesve të shërbimeve sociale duhet të ndahet dhe të bëhet nga dy trupa të ndryshëm dhe do të ishte më efikas nëse monitorimi i rregullt bëhet nga komuna, ndërsa inspektimi i rregullt nga ana e Ministrisë.

Në kuadër të Qëndrimit të publikuar në vitin 2020 për Ligjin e ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, KOMF ka rekomanduar që mandati ekzekutiv i inspektimit dhe monitorimit duhet të përcaktohet me anë të Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare. Konkretisht është rekomanduar ndarja e funksioneve të inspektimit dhe monitorimit, specifikisht monitorimi të bëhet nga zyrtarët përgjegjës në Divizionet përkatëse sipas detyrës zyrtare në DPSF dhe nga niveli komunal, ndërsa inspektimi me kompetenca ekzekutive të bëhet nga niveli qendror. Për më tepër KOMF ka rekomanduar shndërrimin e njësisë së brendshme të inspektimit në një njësi apo agjenci jashtë ministrisë, që do të ndikonte në inspektim të pavarur për të vlerësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe për të administruar licencimin.

Po ashtu, Njësi aktuale i Inspektimit që vepron brenda MFPT nuk ka kompetenca ekzekutive dhe për pasojë nuk ka mundësi të shqiptojë masa, gjopa dhe sanksione. Për pasojë rekomandimet e dhëna nga kjo Njësi mbesin të pazbatuara. Kjo ndodh për shkak të mosdefinimit të rolit të inspektimit në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, ku Njësia për Inspektim nuk ka asnjë mandat ekzekutiv.



Funksionimi aktual i Njesisë për Monitorim dhe Inspektim në kuadër të MFPT, mund të paraqesë konflikt interesi sepse në shumë raste njësia bën inspektim të divizioneve të vetvetes. Për këtë arsye duhet të bëhet ndarja e funksioneve të inspektimit dhe monitorimit, specifikisht monitorimi të bëhet nga niveli komunal, ndërsa inspektimi me kompetenca ekzekutive të bëhet nga niveli qendror.

Në Kosovë nuk ekziston një mekanizëm i qëndrueshëm me kompetenca ekzekutive që do të siguronte transparencë dhe llogaridhënie sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë.

MONITORIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Aktualisht, monitorimi realizohet nga zyrtarët kompetent sipas detyrës zyrtare për shërbime (kategori) të caktuara sociale në kuadër të Divizioneve përkatëse në Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes (DPSF).

Bazuar në intervistat e realizuara, aktualisht, nuk ka sistem monitorimi të mirëfilltë për shërbime sociale nga drejtoritë komunale. Komunat nuk posedojnë instrumentet dhe kapacitetet për monitorim. Monitorimi bëhet zakonisht përmes vizitave, raporteve të punës apo takimeve.

Në asnjë nga shtatë komunat e monitoruara nuk është realizuar ndonjë proces i mirëfilltë i monitorimit të shërbimeve sociale, qoftë në sektorin publik, qoftë në sektorin jo qeveritar. Përfaqësues nga sektori jo qeveritar kanë deklaruar që sidomos në rastet kur nuk kanë projekt apo kontratë me komunën, ato nuk marrin iniciativën as për vizitë dhe as për monitorim.⁷⁵ Lidhur me këtë, përfaqësues nga Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kanë deklaruar që monitorimi bëhet përmes vizitave, raporteve dhe takimeve të ndryshme me ofrues të shërbimeve. Mirëpo, përveç Komunës së Prishtinës, të gjithë të intervistuarit kanë pohuar që nuk ka monitorim të mirëfilltë në kuptim të realizimit të një procesi të rregullt të monitorimit. Ndërkaq, Drejtoresha e Mirëqenies Sociale në Prishtinë ka thënë që DMS cakton një ekip, i cili realizon vizita sistematike në OJQ-të përfituese për të parë nga afër realizimin dhe ecurinë e aktiviteteve. Arsytet kryesore për mos-realizimin e një procesi të monitorimit, sipas tyre janë mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe financiare për këtë çështje.

Përveç monitorimit të mangët nga ana e institucioneve publike, në asnjë institucion të intervistuar, nuk ka raste kur është kryer ndonjë proces i monitorimit të jashtëm nga ana e sektorit jo qeveritar.



Ndaj asnjë prej ofruesve të shërbimeve sociale të intervistuar nga sektori publik dhe jo qeveritar, nuk është realizuar ndonjë proces i mirëfilltë i monitorimit nga ana e nivelit komunal. Po ashtu gjatë intervistave është konstatuar që komunat nuk kanë të zhvilluara instrumente për monitorim.

⁷⁵ Intervistë me Rexhep Gojnovci, Drejtor Ekzekutiv në OJQ ORA Akti, 3 Shkurt 2022

LICENCIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Aktualisht shërbimet e ofruara nga Qendrat për Punë Sociale, nuk janë të licencuara, kjo pasi që Ligji për Shërbime Sociale dhe familjare në fuqi nuk parasheh licencimin e shërbimeve të ofruara nga sektori publik. KOMF ka kërkuar që krahas licencimit të zyrtarëve në QPS, duhet të licencohen edhe shërbimet sociale të ofruara nga QPS-të, bazuar në standardet minimale. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara nga QPS-të dhe rritje të llogaridhënies. Përderisa zyrtarët publik të shërbimeve sociale iu nënshtrohen procesit të licencimit.

Gjatë vitit 2021 nga MFPT janë licencuar 188 zyrtarë dhe 48 subjekte juridike, organizata jo qeveritare, për të ofruar shërbime sociale dhe familjare.⁷⁶

Sipas të dhënave të monitorimit, edhe në vitin 2021 është evidentuar se ende ka organizata jo qeveritare të pa licencuara, që operojnë si ofruese të shërbimeve sociale. Në thirrjet e komunave për financim të analizuara gjatë monitorimit, përfituese ishin edhe organizatat ofruese të shërbimeve sociale që operojnë pa licencë. Edhe Drejtori për Politika Sociale dhe Familjare në kuadër të MFPT, ka thënë që mund të ketë OJQ të tilla. Rreth 300 OJQ të regjistruara kanë si mision ofrimin e shërbimeve sociale, ndërkaq vetëm 50 OJQ deri tani janë të licencuara. Ai ka njoftuar që në fund të vitit 2020 është ndryshuar korniza ligjore për licencimin e ofruesve individual dhe OJQ-ve. Kështu që me këto ndryshime ju është krijuar mundësia e licencimit edhe kompanive private, si dhe është specifikuar lista e shërbimeve sociale, ku shërbimet sociale janë grupuar në total, në 35 shërbime.⁷⁷

⁷⁶ Të dhëna nga Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 12 Prill 2022

⁷⁷ Intervistë me Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 28 Shkurt 2022



PËRFUNDIMI

PËRFUNDIMI


Raporti i Monitorimit “Shërbime Sociale Afër Qytetarit” mbi procesin e decentralizimit për shërbime sociale për vitin 2021, vërteton që ky proces, nuk është implementuar plotësisht as në vitin 2021. Bazuar në të dhënat e raportit, tre shkaktarët kryesorë për mos implementim të këtij procesi janë vullneti politik, situata e krijuar nga pandemia Covid-19 si dhe ndryshimet politike në vend.

Sfida kryesore e të gjithë ofruesve të shërbimeve sociale, vazhdon të jetë rregullimi i financimit të qëndrueshëm për shërbime sociale. Në Kosovë, financimi i shërbimeve sociale mbetet në vullnetin e lirë të komunave, të cilat sipas raportit të monitorimit, nuk kanë prioritetuar shërbimet sociale as në vitin 2021. Përgjatë bën vetëm Komuna e Prishtinës, e cila ka pasur rritje të buxhetit për shërbime sociale përgjatë tre viteve të fundit. Zgjidhja për sigurimin e financimit për shërbime sociale vlerësohet të jetë përmes themelimit dhe implementimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale, i cili pritet të aplikohet me hyrjen në fuqi të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Dy ligjet kryesore që pritet të kenë ndikim në zbatimin e procesit të decentralizimit, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, nuk arritën të miratohen as në vitin 2021, edhe pse janë finalizuar. Problematikë tjetër vazhdon të mbetet mungesa e një skeme të qëndrueshme të kontraktimit të shërbimeve sociale të ofruara nga sektori jo qeveritar, e cila do të ndikonte në ofrimin e shërbimeve sociale të qëndrueshme dhe cilësore.

Kapacitetet e komunave për menaxhim dhe ofrim të shërbimeve sociale kanë vazhduar të jenë të mangëta sikurse në dy vitet paraprake. Përkundër rekomandimeve nga shoqëria civile por edhe nga vetë ofruesit e shërbimeve, nuk ka pasur rritje të numrit të kapaciteteve njerëzore dhe financiare në komuna.

Llogaridhënia ka vazhduar të jetë e ulët si pasojë e mos definimit të qartë të roleve për monitorim dhe inspektim, si dhe mungesës së kompetencave ekzekutive të Njesisë për Inspektim. Komunitat nuk posedojnë as instrumentet dhe as kapacitetet për të zhvilluar procese monitorimi të ofruesve të shërbimeve.



REKOMANDIMET

REKOMANDIMET

Rekomandimet për Qeverinë dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve:

- Miratimi sa më shpejt i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare për rregullimin e çështjeve sikurse: Ndarjen e përgjegjësi të institucioneve të nivelit qendror dhe komunal; Krijimin e një skeme të hapur të ofrimit të shërbimeve sociale në mes të sektorit publik, jo qeveritar dhe atij privat; Ndarjen e funksionit të inspektimit dhe monitorimit në mes të nivelit qendror dhe komunal, fuqizimin e njësisë së inspektimit përmes dhënies së kompetencave ekzekutive; Shndërrimin e njësisë së brendshme të inspektimit në njësi jashtë ministrisë, që do të ndikonte në inspektim të pavarur; Licencimin e shërbimeve sociale të ofruara nga sektori publik.
- Miratimi sa më shpejt i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Grantit Specifik për Shërbime Sociale për të siguruar financim të qëndrueshëm dhe të drejtë për shërbimet sociale dhe familjare. Shuma totale e shpenzimeve aktuale për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për QPS-të dhe financimin e institucioneve rezidenciale, është rreth 10 milionë Euro. Rekomandohet që në vitin e parë të zbatimit të Ligjit të ri për Financat e Pushtetit Lokal (pas miratimit të tij), shuma totale e ndarë përmes Grantit Specifik të jetë 15 milionë Euro, që i bie që buxheti për shërbime sociale të rritet me 5 milionë Euro.
- Hartimi i formulës së financimit për shërbimet sociale nga MFPT. Formula e financimit duhet të nxjerrë koston për njësi për secilin klient për shërbime sociale, si dhe duhet të marrë parasysh indikatorët social.
- Krijimi i një skeme të qëndrueshme nga MFPT për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori jo qeveritar. Kontraktimi duhet të bëhet në emër të blerjes së shërbimeve për ofrimin e shërbimeve sociale për periudha tre vjeçare në mënyrë që të sigurohet financim i qëndrueshëm dhe të eliminohen zbrazëtitë kohore. MFPT duhet të rrisë pragun e minimumit të financimit për shërbimet sociale të ofruara nga sektori jo qeveritar dhe financimi duhet të bëhet bazuar në formulën e financimit; Në të njëjtën kohë, duhet të hartohet edhe udhëzimi administrativ për rregullimin e kontraktimit të shërbimeve nga sektori jo qeveritar.
- Zhvillimi i programeve të akredituara për ofruesit e shërbimeve sociale konform standardeve minimale dhe kërkesave të licencimit. Po ashtu, është më se i domosdoshëm krijimi i një plani vjetor të trajnimeve i dizajnuar nga MFPT dhe i bazuar në programet e akredituara.

Rekomandimet për Komunat:

- Realizimi i analizës me nevojat e qytetarëve për shërbime sociale në secilën komunë, e cila do të shërbente si bazë për planifikimin e shërbimeve dhe buxhetimin e tyre.
- Rritja e buxhetit për shërbime sociale, Qendrat për Punë Sociale dhe sektorin jo qeveritar.
- Krijimi i një skeme të qëndrueshme nga komunat për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori jo qeveritar. Kontraktimi duhet të bëhet në emër të blerjes së shërbimeve dhe jo përmes subvencionimit. Komunat të hartojnë specifikacionet për blerjen/kontraktimin e shërbimeve sociale nga sektori jo qeveritar si dhe duhet tu përmbahen standardeve minimale të MFPT gjatë procesit të kontraktimit.
- Kontraktimi vetëm i organizatave jo qeveritare të licencuara dhe të dëshmuara me përvojën dhe ekspertizën e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të garantuar cilësi dhe profesionalizëm në ofrimin e këtyre shërbimeve.
- Ngritja e kapaciteteve të Drejtorive për Mirëqenie Sociale për planifikim, menaxhim dhe monitorim të shërbimeve sociale. Rekomandohet që Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të zhvillojnë dhe profilizojnë stafin profesional në fushën e shërbimeve sociale. Në secilën Komunë, rekomandohet që në kuadër të kësaj Drejtorie të jetë të paktën një person i profilizuar për menaxhim të shërbimeve sociale.
- Zhvillimi i procesit dhe instrumenteve për monitorim të mirëfilltë të ofruesve të shërbimeve sociale.
- Fuqizimi i DSHMS-ve dhe QPS-ve për planifikim dhe menaxhim të buxhetit. Duke qenë se pas implementimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale, buxheti pritet t'i bartet QPS-ve, ato duhet të jenë të përgatitura për pranim të kompetencave, për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për ofrimin e shërbimeve sociale. Planifikimi buxhetor duhet të bazohet në nevojat e qytetarëve brenda komunës, nevojën për shërbime sociale cilësore, si dhe zhvillimin profesional të ofruesve të shërbimeve.
- Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve për shërbime sociale në QPS për ofrimin e shërbimeve sociale. Rekomandohet që të rritet numri i tyre për të respektuar standardet minimale të MPMS për numrin e zyrtarëve në raport me numrin e përfituesve. Gjithashtu, rekomandohet që QPS-të të kenë në përbërje të tyre profesionistë nga lëmitë e kërkuara me ligj sikurse punëtor social, psikolog, pedagog, sociolog dhe jurist. Gjithashtu, rekomandohet profilizimi i zyrtarëve të shërbimeve sociale në QPS sipas kategorive të përfituesve të shërbimeve. Duke pasur parasysh burimet njerëzore të kufizuara, rekomandohet që ky proces të zhvillohet gradualisht në mënyrë progresive. Si fazë e parë, rekomandohet profilizimi i zyrtarëve të shërbimeve sociale për punën me fëmijë dhe me të rritur.

Rekomandimet për sektorin jo qeveritar:

- Ofrimi i shërbimeve cilësore për fëmijët dhe familjet në nevojë për shërbime sociale.
- Avokimi dhe mobilizimi për shtyrjen përpara të proceseve që përmirësojnë mbrojtjen dhe shërbimet sociale.
- Monitorimi dhe vlerësimi nga sektori jo qeveritar/privat. Krahas monitorimit dhe inspektimit të bërë nga institucionet publike, për të rritur llogaridhënien dhe cilësinë e shërbimeve, rekomandohet monitorimi dhe vlerësimi i jashtëm dhe i pavarur nga sektori jo qeveritar/privat.
- Zhvillimi i fushatave vetëdijësuese për rëndësinë e shërbimeve sociale dhe ndikimin që ato kanë në mirëqenien e qytetarëve.



SHTOJCAT

SHTOJCAT

Shtojca 1 – Lista e të intervistuarve

1.

Mentor Morina

Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes, MFPT

Drejtor i Departamentit të Politikave Sociale dhe të Familjes

2.

Fitore Rexhaj

Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes, MFPT

Zyrtare e lartë për Monitorim dhe Inspektim të Shërbimeve Sociale dhe Familjare

3.

Jeton Gashi

Departamenti për Buxhet, MFPT

Udhëheqës i Divizionit për Buxhet Komunal

4.

Adelina Sahiti

DMS, Komuna e Prishtinës

Drejtor

5.

Vjollca Kabashi

DSHMS, Komuna e Prizrenit

Drejtor

6.

Mimoza Shala Kolshi dhe Hysen Sllamniku

DSHMS, Komuna e Fushë Kosovës

Drejtor dhe Zyrtar për Shërbime Sociale

7.

Shkëlzen Hajdini

DSHMS, Komuna e Lipjanit

Drejtor

8.

Emira Sallahu

DSHMS, Komuna e Ferizajt

Udhëheqëse e Sektorit për Mirëqenie Sociale

9.

Durim Biqkaj

DSHMS, Komuna e Kamenicës

Zyrtar për Shërbime Sociale

10.

Blerim Shabani

QPS, Komuna e Prishtinës

Drejtor

11.

Bashkim Rakaj dhe Avni Ademaj

QPS, Komuna e Prizrenit

Zyrtar për Punë Sociale dhe U.D. Drejtor

12.

Drita Kukaj

QPS, Komuna e Pejës

Drejtor

13.

Abaz Gjigoli

QPS, Komuna e Fushë Kosovës

Drejtor

14.

Makfirete Shamolli

QPS, Komuna e Lipjanit

Drejtor

15.

Adelina Rexhepi

QPS, Komuna e Ferizajt

Drejtor

16.

Rifat Hajdari

QPS, Komuna e Kamenicës

Drejtor

17.

Ermira Shabani

Down Syndrome Kosova (OJQ), Komuna e Prishtinës

Udhëheqëse Nationale e Programit të Shërbimeve në DSK

18.

Aida Topanica

Autizmi (OJQ), Komuna e Prishtinës

Udhëheqëse e Punës Terapeutike

19.

Teuta Abrashi

MVPT (OJQ), Komuna e Prishtinës

Drejtor Ekzekutiv

20.

Liridona Zogaj

Qendra e Kujdesit Ditor Pema

Drejtor Ekzekutiv

21.

Rexhep Gojnovci

ORA - Akti (OJQ), Komuna e Fushë Kosovës

Drejtor Ekzekutiv

22.

Xhemile Murseli

Handikos (OJQ), Komuna e Ferizajt

Drejtor Ekzekutiv

23.

Hyrmete Morina

Handikos (OJQ), Komuna e Kamenicës

Drejtor Ekzekutiv

24.

Besime Tusha

NOPM (OJQ), Komuna e Kamenicës

Drejtor Ekzekutiv

Shtojca 2 – Pyetësorët për monitorimin e procesit të decentralizimit:

■ Pyetësori për Departamentin për Politika Sociale dhe Familjare - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

1. A është evidentuar ndonjë ndryshim ose progres lidhur me zbatimin e procesit të decentralizimit, krahasuar me vitin 2020?
2. Sa ka ndikuar pandemia Covid- 19 në implementimin e procesit të decentralizimit përfshirë këtu nismat legislative, proceset apo projektet e nisura më herët?
3. Cilat janë ndryshimet kryesore të cilat pritet të sjellin dy ligjet e reja: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, në fushën e shërbimeve sociale?
4. A mendoni që ka nevojë për trajnime, punëtori për ofruesit e shërbimeve në nivel komunal për risitë që dalin nga Ligji për Shërbime Sociale?
5. A është bërë decentralizimi i buxhetit për shërbime sociale në vitin 2021?
6. A mendoni se përmes Grantit specifik do të zgjidhet ky proces?
7. Në cilën fazë është procesi i hartimit të formulës së financimit, apo nxjerrjes së kostos së shërbimeve për njësi në vitin 2021?
8. Sa ofrues të shërbimeve sociale janë të licencuar në Kosovë momentalisht?
9. A ka ofrues të shërbimeve sociale që ofrojnë shërbime pa licencë?
10. A duhet që në të ardhmen të licencohen edhe QPS-të për ofrim të shërbimeve sociale?
Nëse po, sqaro arsyen.
11. Si ndahet buxheti për QPS-të dhe OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime sociale?
- A ekzistojnë kritere të qarta dhe nëse po, cilat janë ato?
12. A është shpallur thirrja për financimin e shërbimeve sociale për vitin 2021, nëse po në cilin muaj, sa ka qenë shuma e parashikuar për financim të shërbimeve sociale dhe cili është numri i OJQ -ve që kanë përfituar nga kjo thirrje?
13. Financimi përmes subvencionimit është treguar si formë e pa përshtatshme për financimin e shërbimeve sociale. A ka në plan ministria të zhvillojë një skemë të qëndrueshme të financimit përmes blerjes së shërbimeve për periudha tre vjeçare, duke qenë se kjo është paraparë në planin e qeverisë 2021 – 2025?
14. A ka hartuar/krijuar Ministria apo ndonjë institucion tjetër programe të akredituara për zhvillimin profesional të ofruesve të shërbimeve sociale?
- Sa është e nevojshme të zhvillohen programet e akredituara për ofruesit e shërbimeve sociale?

15. Cila është mënyra e komunikimit apo raportimit të brendshëm në mes të Ministrisë, DSHMS, QPS-ve dhe OJQ-ve të tjera që ofrojnë shërbime sociale dhe si ka funksionuar komunikimi gjatë periudhës së pandemisë?
16. A ka ndonjë plan nga MFPT për të zgjidhur problemin e identifikuar rreth raportimit dhe komunikimit mes nivelit qendror dhe komunal (përfshirë raportimin nga OJQ-të) dhe a pritët që MPMS të hartojë ndonjë Udhëzim Administrativ apo protokoll për raportim?

■ **Pyetësi për Departamentin për Politika Sociale dhe Familjare - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Njësia për monitorim dhe inspektim të shërbimeve sociale**

1. Në përgjithësi a është evidentuar ndonjë ndryshim ose progres lidhur me monitorimin dhe inspektimin, krahasuar me vitin 2020?
2. Sa ka ndikuar pandemia Covid-19 në procesin e inspektimit dhe a janë krijuar vështirësi gjatë inspektimit dhe a ka pasur ndonjë lehtësim/përmirësim gjatë vitit 2021?
3. A keni pasur udhëzime nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me funksionimin e shërbimeve sociale gjatë pandemisë dhe sa ka qenë e nevojshme?
4. Cilat veprime ka ndërmarrë ministria për të përmirësuar monitorimin dhe inspektimin?
5. A priten ndryshime apo risi nga Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare në fushën e monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve sociale në Kosovë?
6. Si bëhet licencimi i ofruesve të shërbimeve sociale dhe cilat janë kriteret për licencim?
7. Sa ofrues të shërbimeve sociale janë të licencuar në Kosovë?
8. A ka ofrues të shërbimeve sociale që ofrojnë shërbime pa licencë?
9. A duhet që në të ardhmen të licencohen edhe QPS-të për ofrim të shërbimeve sociale?
Nëse po, sqaro arsyen.
10. A ka Ministria rol monitorues në relacion me shërbimet sociale?
Nëse po, si bëhet monitorimi?
Nëse jo, a duhet të ketë rol monitorues?
11. Cilat janë nevojat e Departamentit të Inspektimit të Shërbimeve Sociale dhe Familjare?
12. Cili është numri i inspektorëve për shërbime sociale për tërë Kosovën aktualisht?
13. Sa herë në vit realizohet procesi i rregullt inspektimit në komunat e Kosovës?
14. Sa herë është realizuar inspektim i rregullt në komunat e Kosovës gjatë vitit 2021 dhe si ka qenë mënyra e inspektimit?
15. Cila është mënyra e komunikimit të brendshëm në mes të Ministrisë, DSHMS-ve, QPS-ve dhe OJQ-ve të tjera që ofrojnë shërbime sociale?
 - A ka forma (protokolle) të raportimit?
 - Në çfarë periudhash kohore bëhet raportimi?
 - Nëse ka protokolle, a respektohen ato?

■ Pyetësori për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Buxhet

1. A është decentralizuar buxheti për shërbime sociale dhe cila është forma aktuale e financimit të shërbimeve sociale gjatë vitit 2021?
2. Për vitin 2021, sa është shuma e buxhetit të ndarë për shërbime sociale në kuadër të buxhetit të Republikës së Kosovës?
3. A ka pasur vullnet politik nga ana e Ministrisë për zgjidhjen e problemit të financimit të shërbimeve sociale, krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale? (sqaro)
4. Deri në cilën fazë ka arritur procesi i hartimit të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal?
5. Sa ka ndikuar pandemia Covid – 19 si dhe zgjedhjet nacionale dhe lokale në aprovimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal?
6. Cila është zgjidhja e duhur për decentralizimin e buxhetit të shërbimeve sociale?
7. A mund të tregoni se si Granti i Veçantë për Shërbime Sociale do të ndihmonte zgjidhjen e problemit të decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale?
 - a) Sa do të jetë shuma e buxhetit që do të ndahet në kuadër të Grantit specifik për shërbime sociale?
 - b) A keni komente rreth formulës së financimit?
 - c) Kur pritet që Komisioni i Granteve të aprovojë Grantin specifik, në mënyrë që ai të hyjë në fuqi?
8. Cila është mënyra e komunikimit apo raportimit të brendshëm në mes të Ministrisë së Financave, MPMS dhe Komunave?
9. Si është bashkëpunimi në mes të nivelit qendror, lokal dhe OJQ-ve?

■ Pyetësori për nivelin komunal (komunat/DSHMS):

1. Deri në cilën fazë ka arritur procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale në Kosovë?
2. Në përgjithësi a është evidentuar ndonjë ndryshim ose progres lidhur me zbatimin e procesit të decentralizimit, krahasuar me vitin 2020?
3. Sa ka ndikuar pandemia Covid – 19 në implementimin e procesit të decentralizimit përfshirë këtu nismat legjislative, proceset apo projektet e nisura më herët?
4. A ka pasur rritje të kërkesës për shërbime sociale si pasojë e shfaqjes së pandemisë, dhe nëse po si u është përgjigjur DShMS nevojave të tilla?
5. A është përmirësuar qasja në shërbime sociale gjatë vitit 2021?
6. A ka pasur udhëzime të qarta ose të veçanta nga Ministria e Shëndetësisë për ofrimin e shërbimeve sociale gjatë pandemisë?
 - Nëse po, cilat ishin udhëzimet?
 - Nëse jo, a ka qenë e nevojshme?

7. A janë kompetencat të përcaktuara në mënyrë të qartë në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal, sa i përket procesit të decentralizimit? (sqaro)
8. A kapasur vullnet politik nga ana e Komunës për të implementuar procesin e decentralizimit? (sqaro)
9. A është bërë decentralizimi i buxhetit për shërbime sociale?
 - 1.1 Cila është zgjidhja e duhur për decentralizimin e buxhetit të shërbimeve sociale?
 - 1.2 A mendoni se përmes Grantit të veçantë do të zgjidhet ky proces?
- a) Nëse po, sqaro se si ky Grant do të ndihmonte zgjidhjen e problemit të decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale?
- b) Nëse jo, cila do të ishte zgjidhja e duhur për decentralizim të buxhetit të shërbimeve sociale?
10. A ka shpallur Komuna thirrje për financimin e shërbimeve sociale në vitin 2021, nëse po sa ka qenë shuma, për sa OJQ është bërë ndarja dhe në cilin muaj është shpallur?
11. Si ndahet buxheti për OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime sociale?
 - 11.1 Si bëhet kontraktimi i shërbimeve sociale nga komunat?
 - 11.2 A ekzistojnë kritere të qarta dhe nëse po, cilat janë ato (listo)?
 - 11.3 Si përcaktohen prioritetet dhe kriteret në kuadër të thirrjeve për financimin e shërbimeve sociale?
 - 11.4 A shpall komuna thirrje në mënyrë të rregullt për kontraktimin e shërbimeve sociale nga OJQ-të?
12. A keni ju si komunë informacione të sakta lidhur me numrin e personave që janë në nevojë brenda komunës tuaj?
 - 12.1. Si merren këto informacione?
13. A ka DShMS kapacitete njerëzore, burime njerëzore të kualifikuara dhe me eksperiencë për shërbimet sociale?
 - 13.1. Sa është numri i stafit brenda DSHMS?
 - 13.2. Cilat janë profilet (profesionet) e tyre?
14. A i monitoron DShMS institucionet që ofrojnë shërbimet sociale (përfshirë këtu QPS-të dhe OJQ-të)?
 - 14.1. Nëse po, si bëhet monitorimi?
15. A ka DShMS dhe QPS kapacitete të hartojë planifikimin buxhetor (kërkesën) për shërbime sociale?
 - 1.1 Nga kush bëhet kërkesa për buxhet drejtuar Komunës?
 - 1.2 A ka kapacitete Drejtoria dhe QPS rreth procedurave të prokurimit për kontraktimin e shërbimeve sociale?
 - 1.3 A ka kapacitete QPS që të bëjë menaxhimin e buxhetit?

16. Cila është mënyra e komunikimit të brendshëm në mes të Ministrisë, DShMS, QPS-ve dhe OJQ-ve tjera që ofrojnë shërbime sociale?
 - 16.1 A ka forma (protokolle) të raportimit?
 - 16.2 Në çfarë periudha kohore bëhet raportimi?
 - 16.3 Nëse ka protokolle, a respektohen ato?
17. A mendoni që QPS-të duhet të dërgojnë raportet e njëjta për raste në MPMS dhe DShMS?

Për drejtorët e rinj:

1. Cilat do të jenë ndryshimet konkrete që do të sjellni në këtë Drejtori?
2. Sa ka njohuri stafi që keni për shërbimet sociale dhe a ka staf tëveçantë për mirëqenie sociale?
3. A keni në plan të organizoni një hulumtim në terren për nevojat e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale?
4. A keni plan konkret për organizimin e shërbimeve sociale në komunë?

■ Pyetësori për Qendrat për Punë Sociale:

1. Në përgjithësi a është evidentuar ndonjë ndryshim ose progres lidhur me zbatimin e procesit të decentralizimit, krahasuar me vitin 2021?
2. Sa ka ndikuar pandemia Covid – 19 në implementimin e procesit të decentralizimit përfshirë këtu nismat legislative, proceset apo projektet e nisura më herët?
3. A ka pasur rritje të kërkesës për shërbime sociale si pasojë e shfaqjes së pandemisë dhe në vitin e dytë të pandemisë, dhe nëse po si u është përgjigjur QPS nevojave të tilla?
4. A keni pasur udhëzime të qarta dhe të veçanta nga Ministria e Shëndetësisë për ofrimin e shërbimeve gjatë pandemisë?
5. A janë kompetencat të përcaktuara në mënyrë të qartë në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal, sa i përket procesit të decentralizimit? (sqaro)
6. A ka pasur vullnet politik nga ana e Ministrisë dhe Komunës për të implementuar procesin e decentralizimit? (sqaro)
7. A është bërë decentralizimi i buxhetit për shërbime sociale?
 - 7.1. Cila është zgjidhja e duhur për decentralizimin e buxhetit të shërbimeve sociale?
 - 7.2. A mendoni se përmes Grantit të veçantë do të zgjidhet ky proces?
 - a) Nëse po, sqaro se si ky Grant do të ndihmonte zgjidhjen e problemit të decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale?
 - b) Nëse jo, cila do të ishte zgjidhja e duhur për decentralizim të buxhetit të shërbimeve sociale?
8. Cila ka qenë shuma e ndarë për vitin 2021 për shërbime sociale në këtë QPS?
9. Cila ka qenë shuma e ndarë për vitin 2020 për shërbime sociale në këtë QPS?

10. A i mbulon buxheti aktual nevojat e shërbimeve sociale?
 - 10.1 Për cilat nga shërbimet ju keni buxhet të mjaftueshëm (listo)?
11. A ka QPS kapacitete të hartojë planifikimin buxhetor për shërbime sociale?
 - 11.1 Nga kush bëhet kërkesa për buxhet drejtuar Komunës?
12. A ka QPS kapacitete për menaxhimin e buxhetit për shërbime sociale?
 - 12.1 A mendoni që QPS duhet të ketë konton e saj bankare dhe të menaxhojë me buxhetin, apo duhet që buxheti të menaxhohet nga komuna (DShMS)?
 - 12.2 A ka QPS financier?
- 13 Cila është mënyra e komunikimit të brendshëm në mes të Ministrisë, DShMS-ve, QPS-ve dhe OJQ-ve tjera që ofrojnë shërbime sociale?
 - 13.1 A ka forma (protokolle) të raportimit?
 - 13.2 Në çfarë periudhash kohore bëhet raportimi?
 - 13.3 Nëse ka protokolle, a respektohen ato?
 - 13.4 Çfarë raportesh dorëzohen në DShMS dhe çfarë në MPMS (shpjegoni)?
- 14 A mendoni që duhet të dërgohen raportet e njëjta për raste në MPMS dhe DShMS?

■ **Pyetësori për OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale:**

1. Cilat shërbime ofron OJQ ku ju veproni aktualisht?
2. Në përgjithësi a është evidentuar ndonjë ndryshim ose progres lidhur me zbatimin e procesit të decentralizimit, krahasuar me vitin 2021.
3. A ka pasur rritje të kërkesës për shërbime sociale si pasojë e shfaqjes së pandemisë dhe gjatë vitit të dytë të pandemisë, dhe nëse po si u është përgjigjur OJQ ku ju veproni nevojave të tilla?
4. A keni pasur udhëzime konkrete nga MSH ose MFPT për ofrimin e shërbimeve sociale gjatë pandemisë? Cilat ishin sfidat?
5. Si financohen shërbimet sociale në OJQ-në ku veproni?
 - 5.1. Aktualisht, nga cilat burime (donatorë) mbulohen shërbimet sociale të organizatës tuaj?
6. A nxjerr komuna shpallje thirrje për financimin e shërbimeve sociale?
 - 6.1. Nëse po, a informoheni me kohë dhe a janë të qarta kriteret për financim?
7. Cila ka qenë shumica e ndarë për shërbime sociale nga ana e nivelit qendror dhe nga ana e nivelit komunal për vitin 2021 dhe 2020?
8. A i mbulon buxheti aktual nevojat e shërbimeve sociale?
9. Sipas jush, cila do të ishte mënyra e duhur e financimit të shërbimeve sociale për sektorin jo-qeveritar?
10. Cila është mënyra e raportimit nga ju drejt Komunës, DShMS, QPS dhe MPMS? (nëse bëhet raportimi)

11. A keni pasur monitorim/inspektim nga Komuna?
12. Cilat janë sfidat dhe nevojat me të cilat përballet OJQ në ofrim të shërbimeve sociale?

Shtojca 3 – Dokumentet e shqyrtuara

Korniza ligjore:

Ligji nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal
Ligji nr. 05/L-108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal
Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020
Ligji nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë
Ligji nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë
Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare
Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare
Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale
Strategjia sektoriale e MPMS 2014 – 2020
Statutet e Qendrave për Punë Sociale
Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal, Ministria e Financave
Koncept Dokumenti për Shërbime Sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Raportet:

Analiza e Nevojave për Kapacitetet e Qendrave për Punë Sociale në Kosovë në Fushën e Promovimit dhe Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Handikos, Tetor 2020
Emergjenca shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, Avokati i Popullit, 2021
Financimi i Shërbimeve Sociale, KOMF 2017
Hartëzimi i sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve në EU, Agjencia e Bashkimit European për të Drejtat të Njeriut
Konteksti ligjor dhe fiskal si dhe kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale në Kosovë, Analizë e situatës, Save the Children 2018
Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës, KOMF 2017 dhe 2018
Platforma buxhetore, Instituti GAP
Raporti i Progresit të Kosovës 2021, Zyra e BE-së në Kosovë
Raporti për vitin 2021, Avokati i Popullit, 2021
Sfidat e Qendrave për Punë Sociale në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19, Instituti GAP, 2021

Organizatat anëtare të KOMF: Asociacioni për Trajtime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, BalkanSunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, EducationComesFirst – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The IdeasPartnership, VoRAE, PublicOrganizationforLocalInitiativesandSupports – POLIS, NetworkofPeaceMovement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti, Nevo Koncepti, Qendra Labyrinth, Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN), Down Syndrome Kosova, Organizata “Autizmi”, Handikos Gjakovë dhe Handikos Ferizaj.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Adresa: Rr. Sejdi Kryeziu, HY.1 K.4 No. 14

Tel: +383 (0) 38 220 287

Email: Info@komfkosova.org

Website: www.komfkosova.org



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Implementuar nga:

